



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS SH.A. PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK sh.a.), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. deri me 31 dhjetor 2025, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të Kualifikuar

Çështjet që kanë ndikuar në opinionin e kualifikuar janë si në vijim:

- B1 Ndërmarrja nuk ka arritur të finalizojë përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme, përkundër veprimeve të ndërmarra gjatë vitit 2025. Në regjistër vazhdojnë të figurojnë prona që nuk janë në pronësi të ndërmarrjes, përfshirë pesë prona të transferuara te Infracos në vlerë 7,867,541€, 11 parcela të identifikuara për fshirje në vlerë 866,223€, si dhe prona “Mali i pyllëzuar” në Podujevë në vlerë 5,000,000€. Po ashtu, prona në Prishtinë nuk është përditësuar sipas certifikatës së pronësisë, ndërsa ajo në Vasilevë është vetëm pjesërisht e regjistruar. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në regjistrin e pasurive, përfshirë përshkrime të paplota dhe parcela të pabartura nga proceset e shpronësimit.
- B2 Menaxhmenti gjatë vitit 2023 ka kryer rivlerësim vetëm për kategorinë e tokave, ndërsa kategoritë tjera të pasurive janë mbajtur sipas modelit të kostos fillestare. Megjithatë, regjistri i pasurive përmban 472 pasuri me vlerë neto 7,744,723€ që nuk janë në përputhje me këtë model. Në regjistër janë 5,376 pasuri me vlerë fillestare, të rivlerësuar dhe vlerë neto zero, duke përfshirë objekte, rrugë, hekurudha, rrjete, largpërçues, pajisje dhe makineri.
- B3 Ndërmarrja nuk kishte bërë trajtimin e plotë të rezultateve të komisionit të inventarizimit dhe nuk kishte bërë harmonizimin e plotë të rezultateve me shënimet kontabël, të cilat përshijnë mos harmonizim të pasurive në vlerë 135,501€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqrave Financiare’.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Çështjet që kanë ndikuar në konkluzionin e kualifikuar janë si në vijim:

- A1 Ndërmarrja gjatë vitit 2025 ka nënshkruar kontrata furnizimi me konsumatorë komercialë, prej të cilave 32 nuk kanë përmbushur kërkesën për garancion bankar ose parapagim, sipas kushteve kontraktuale për menaxhimin e riskut kreditor.
- A2 Ndërmarrja pas pranimit të raportit të KOSTT mbi tepricat e energjisë, nuk ka arritur të dokumentoj vendimmarrjen rreth ndarjes së sasive që do të tregtohen përmes bursës ALPEX/bursave tjera dhe/apo ankandit, sipas procedurave të brendshme.
- A3 Procesi i tregtimit të tepricave të energjisë bazohet në procedurën e brendshme dhe realizohet përmes bursave dhe ankandeve, megjithëse mungojnë mekanizma të mjaftueshëm për monitorim dhe kontroll të brendshëm. Ankandet zhvillohen përmes një sistemi e-maili në Microsoft Exchange Server 2010, i cili është jashtë mbështetjes dhe nuk ofron përditësime të sigurisë, si dhe nuk ka gjurmë auditimi, duke mos lejuar verifikim të saktë të aktiviteteve.
- B4 Gjatë vitit 2025, ndërmarrja ka lidhur gjashtë kontrata të negociuara: tri për acid klorhidrik (240,030€) dhe tri për mazut (1,404,465€). Këto u bënë për shkak të pamundësisë për të finalizuar procedurat e hapura për shkak të ankesave dhe mangësive në procedurat tenderuese, përfshirë gabimet në specifikime dhe kriteretë diskriminuese.
- A4 Ndërmarrja nuk kishte aplikuar siç duhet kriteretë në tri dosje të tenderit sipas kërkesave të LPP-së, pasi që kërkesat mbi kapacitetet teknike dhe/ose profesionale nuk kishte specifikuar vlerat e kontratave të realizuara.
- A5 Në 12 raste të furnizimit me gazra industrial, ndërmarrja nuk ka arritur të dëshmojë se menaxheri i kontratës ka aprovuar përputhshmërinë e furnizimeve me kushtet e kontratës si dhe nuk ka qenë pjesë e komisionit për pranimin e furnizimeve. Përveç kësaj në dosje të lëndëve mungojnë dëshmitë e konfirmimit se malli i pranuar është furnizuar nga prodhuesi i deklaruar dhe i certifikuar sipas standardeve ISO, të cilat ishin kërkuar në dosjen e tenderit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në raportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklarata e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkuara me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç përshkruhet në seksionin e bazës për opinionin e kualifikuar:

- 1 Mos përditësimi i regjistrit të pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme.
- 2 Dobësi në prezantimin e pasurive afatgjata, përfshirë trajtim të ndryshëm të pasurive të ndërmarrjes
- 3 Ndërmarrja nuk ka trajtuar plotësisht diferencat e identifikuar nga inventarizimi dhe nuk ka harmonizuar rezultatet me shënimet kontabël.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a..

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KEK sh.a. me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Gjetjet që kanë ndikuar në opinionin e pasqyrave financiare janë: mos përditësimi i regjistrit të pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme, dobësi në prezantimin e pasurive afatgjata, përfshirë trajtim të ndryshëm të pasurive të ndërmarrjes dhe mangësi në trajtimin, raportimin dhe pasqyrimin kontabël të rezultateve të inventarizimit vjetor.

Të konkluzioni i pajtueshmërisë kanë ndikuar: mosaplikimi i garancionit bankar për një pjesë të konsumatorëve komercialë, mungesë e dokumentimit në vlerësimin dhe ndarjen e tepricave të energjisë për tregtim në bursë/ankande, zbatim i procedurave të negociuara pa publikim për shkak të mangësive në procedurat e rregullta, vendosja e kriterëve në dosje të tenderit jo në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik dhe mangësi në procedurën e pranimit të furnizimeve dhe dokumentimit.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e burimeve të sektorit publik.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre gjashtë janë rekomandime të reja dhe gjashtë të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos përditësimi i regjistrit të pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme

Gjetja Sipas SNK 16, Toka, ndërtesat, makineritë dhe pajisjet klasifikohen si pasuri materiale që mbahen për përdorim në prodhimin ose ofrimin e mallrave dhe shërbimeve, për dhënie me qira palëve të treta apo për qëllime administrative, dhe që pritet të përdoren për më shumë se një periudhë raportuese. Gjithashtu sipas paragrafit 112 të SNK 1, njësia ekonomike duhet të shpalosë në shënimet shpjeguese çdo informacion shtesë që nuk është paraqitur drejtpërdrejt në pasqyrat financiare, por që është i rëndësishëm për të kuptuar saktë përmbajtjen dhe qëllimin e tyre nga përdoruesit.

Menaxhmenti i ndërmarrjes gjatë vitit 2025 kishte ndërmarrë veprime, me qëllim të përditësimit të regjistrit të pasurive dhe për të reflektuar gjendjen faktike dhe kontabël për pronat e paluajtshme, megjithatë nuk kishte arritur të bëjë përditësimin e plotë të tyre, si në vijim:

- Sipas çertifikatës së pronësisë, ndërmarrja ka në pronësi 1.72 hektarë tokë (të regjistruar 15.9 ari) në qendër të Prishtinës dhe një lokal 140m². Gjatë vitit ndërmarrja kishte kërkuar historiatin nga Institucionet e Republikës së Kosovës për tokën, por deri në datën e bilancit nuk ka arritur të bëjë përditësimin e kësaj prone në regjistrin e pasurive të harmonizuar me dëshminë e pronësisë, përderisa për lokalin ndërmarrja ende është në proces të trajtimit të kësaj prone me procedura gjyqësore për shkak të uzurpimit të pjesshëm të kësaj prone;
- Në regjistrat e pasurive janë të evidentuara pesë pasuri (kategori e tokave), me vlerë 7,867,541€, të cilat nuk janë në pronësi të ndërmarrjes. Këto pasuri sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës vitit 2010 iu ishin bartur ndërmarrjes publike Infrakos sh.a., përkatësisht përmes Marrëveshjes për transferimin e pasurisë në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Infrakos.sh.a., të vitit 2012;
- Ndërmarrja sipas aktvendimit të shpronësimeve është pronare e 116,88 hektarë tokë në zonën kadastrale Vasilevë (Komuna e Glllogocit). Në regjistrat e pasurive ka të regjistruar sipërfaqe 61.1 hektarë, përderisa për pjesën tjetër është në proces gjyqësor dhe deri në datën e bilancit nuk ka arritur të bëjë përditësimin e kësaj prone në regjistrin e pasurive;
- Në regjistrin e pasurive të ndërmarrjes figuron një parcelë tokë me sipërfaqe prej 1,250 hektarësh, e emërtuar si “Mali i pyllëzuar” që është në territorin e Podujevës, me vlerë të regjistruar prej 5,000,000€. Megjithatë, sipas dëshmive të auditimit titullari i kësaj prone është Agjencia e Pyjeve të Kosovës. Me datë 31.01.2025 sipas vendim të Qeverisë së Kosovës një pjesë e kësaj prone i është dhënë në shfrytëzim Forcës së Sigurisë së Kosovës.
- Në regjistrin e pasurive gjithashtu ekzistojnë 11 parcela, me vlerë 866,223€ të cilat nuk janë në pronësi të ndërmarrjes sipas Agjencionit Kadastral të Kosovës. Ato toka janë rekomanduar që të shlyhen nga regjistri i pasurive që nga viti 2023 me rastin e rivlerësimit;

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja kishte formuar një grup punues (task forcë) për evidentimin e të gjitha pronave të paluajtshme, i cili gjithashtu kishte rekomanduar ç’regjistrimin nga shënimet kontabël të malit të pyllëzuar dhe 11 parcelave që nuk janë në pronësi të saj. Po ashtu, sipas këtij grupi punues janë evidentuar prona/apartamente me përshkrim të mangët në regjistrat kontabël, si dhe mos bartje të pronësive nga proceset e shpronësimeve ndër vite.

Mos prezantimi i plotë dhe i saktë i pronave të paluajtshme kishte ndodhur për shkak të kompleksitetit të çështjeve pronësore që ndërliken me palët e treta, si dhe mungesës së veprimeve efektive të ndërmarrja nga ndërmarrja ndër vite.

Ndikimi Mangësitë në përditësimin dhe harmonizimin e regjistrit të pasurive me gjendjen faktike dhe juridike ndikojnë në paraqitje jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare, duke rritur rrezikun e mbivlerësimit apo nënvlerësimit të tyre, si dhe krijojnë pasiguri juridike mbi pronësinë dhe kufizojnë menaxhimin efektiv të pasurive.

Rekomandimi B1 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë përditësimin e regjistrit të pasurisë me gjendjen aktuale duke prezantuar saktë dhe drejtë pasurinë afatgjatë të ndërmarrjes në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Dobësi në prezantimin e pasurive afatgjata, përfshirë trajtim të ndryshëm të pasurive të ndërmarrjes

Gjetja Sipas Kornizës Konceptuale për Raportimin Financiar (paragrafi 2.12-2.14), informacioni financiar duhet të paraqesë në mënyrë të drejtë dhe të besueshme pozicionin financiar të entitetit, duke reflektuar në mënyrë besnike transaksionet dhe duke u bazuar në evidenca të sakta dhe të plota kontabël.

Sipas SNK 16 - Pasuritë, Impiantet dhe Pajisjet (paragrafi 29, 37 dhe 51), entiteti duhet të zgjedhë si politikë kontabël modelin e kostos ose modelin e rivlerësimit dhe ta zbatojë atë në mënyrë konsistente për një klasë të tërë të pasurive afatgjata, dhe jo në baza individuale. Për më tepër, vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e pasurive duhet të rishikohet të paktën në fund të çdo periudhe raportuese vjetore, për të verifikuar nëse pritshmëritë aktuale janë në përputhje me vlerësimet e mëparshme.

Gjithashtu, sipas SNRF 1 (paragrafi D5), për pasuritë për të cilat nuk ekziston një kosto historike e besueshme, entiteti duhet të përcaktojë vlerën e drejtë si kosto fillestare, për të siguruar paraqitje të drejtë dhe të besueshme në pasqyrat financiare.

Ndërmarrja gjatë vitit 2023 ka kryer rivlerësimin e kategorisë së tokave, ndërsa rivlerësimi i kategorive të tjera nuk është realizuar për shkak që ndërmarrja ka vendosur që kategoritë tjera t'i mbajë sipas modelit të koston fillestare.

Megjithatë, në kuadër të regjistrit të pasurive të ndërmarrjes janë 472 pasuri (nuk përfshihet kategoria e tokave), me vlerë neto kontabël 7,744,723€ të cilat ndër vite kanë qenë të rivlerësuara dhe nuk mbahen me modelin e koston, ku në përbërje kanë kategori të ndryshme të pasurive.

Për më tepër, 69% e pasurive të regjistruara (14,077 nga 20,316 artikuj), me vlerë fillestare prej 229 milion euro, janë pasuri në përdorim, por të zhvlerësuara plotësisht (me vlerë kontabël zero). Nga këto pasuri, 35% prej tyre përfshijnë pasuri kyçe si pajisje për prodhimin e energjisë dhe thëngjillit, objekte, softuer dhe toka për mihje - të cilat gjenerojnë të hyra të rregullta për ndërmarrjen - ndërsa 65% përfshijnë pajisje dhe inventar zyre.

Gjithashtu, në regjistrin e pasurive figurojnë 5,376 pasuri pa vlerë fillestare, pa vlerë të rivlerësuar, e rrjedhimisht edhe vlerë neto zero. Këto pasuri përfshijnë kategori të rëndësishme të veprimtarisë së ndërmarrjes si: objekte, rrugë, hekurudha, rrjete, largpërçues, pajime dhe makineri.

Pasuritë nuk janë paraqitur gjithmonë me trajtim të njëjtë dhe konsistent, për shkak të volumit të madh të pasurive, vështirësisë së rivlerësimit në një industri specifike, mbajtjes së regjistrave në sisteme të ndryshme dhe kompleksitetit të harmonizimit të shënimeve me raportin përfundimtar të inventarizimit.

Ndikimi Mospërputhja dhe trajtimi jo i njëjtë i pasurive rrezikon paraqitjen e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, pasi vlerat e raportuara nuk reflektojnë vlerën e saktë të pasurive.

Rekomandimi B2 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që politika kontabël për pasuritë afatgjata të zbatohet në mënyrë konsistente brenda çdo kategorie të pasurive, duke përfshirë rivlerësimin ose përdorimin e modelit të koston sipas standardeve përkatëse. Gjithashtu të sigurojë që vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e pasurive të rishikohen të paktën në fund të çdo periudhe raportuese vjetore, dhe për pasuritë pa kosto historike të besueshme, të përcaktohet vlera e drejtë si kosto fillestare, në mënyrë që pasuritë të pasqyrohen në mënyrë të drejtë në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Mangësi në trajtimin, raportimin dhe pasqyrimin kontabël të rezultateve të inventarizimit vjetor

Gjetja Sipas nenit 12 të Ligjit Nr.06/L- 032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Rezultatet nga raporti i inventarizimit duhet të barazohen me librat kontabël.

Ne kemi identifikuar që ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimin e plotë të shënimeve kontabël sipas rezultateve të procesit të inventarizimit për të gjitha pasuritë dhe stoqet, për shkak të kriterëve të vendosura në procesin e harmonizimit.

Komisioni i inventarizimit kishte identifikuar një numër pasurish jo funksionale, ndër të cilat edhe pasuri me vlerë neto në libra prej 135,501€, për të cilat ishte propozuar trajtim i mëtejshëm në përputhje me gjendjen e tyre faktike. Megjithatë, këto pasuri nuk janë harmonizuar me shënimet kontabël. Po ashtu, nuk është bërë harmonizimi i stoqeve për të gjithë inventarin e imët të blera pas datës 01.01.2021.

Për më tepër, nga mostrat e testuara janë evidentuar edhe mangësitë tjera, të cilat nuk janë shqyrtuar në raportin vjetor të inventarizimit si dhe gjenden në shënimet kontabël si në vijim:

- 33 apartamente nga fletëregjistrimet e komisioneve të inventarizimit janë evidentuar për ç'regjistrim në vlerë neto 25,428€, dy prej të cilat janë të evidentuara si pa lokacion, një gjendet në një shtet tjetër, tri apartamente janë të regjistruara nga dy herë, si dhe 15 prej tyre kanë përshkrimin "Banesa "60 m²";
- stoku me përshkrimin "Çelik i plotë seksion rrethor Ø 12X80 Fllak ÇL13", sipas komisionit të inventarizimit ishte 2551 njësi, ndërsa sipas shënimeve kontabël 1701, rezulton në mospërputhje prej 850 njësi apo 116,271€. Ndërmarrja ka bërë korigjimin në kartelë të stokut pas datës së bilancit (04.05.2026), por e njejta nuk është korigjuar edhe në pasqyrat financiare.

Trajtimi jo i plotë i rezultateve të komisionit të inventarizimit, si dhe mungesa e harmonizimit të tyre me shënimet kontabël, kanë ardhur si rezultat i mangësive në trajtimin e mospërputhjeve të identifikuara dhe vendimit të Bordit Drejtues i cili nuk kishte dhënë ndonjë arsyetim.

Ndikimi

Mospërputhjet ndërmjet shënimeve kontabël dhe rezultateve të procesit të inventarizimit ndikojnë në paraqitje jo të drejtë të pasurive dhe stoqeve, si dhe rrisin ekspozimin ndaj rrezikut të keqpërdorimit.

Rekomandimi B3

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të realizohet në përputhje me kërkesat ligjore. Pas vlerësimit të të gjitha rezultateve dhe miratimit të raportit përfundimtar të inventarizimit, të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin e plotë të rezultateve me librat kontabël sipas gjendjes faktike të identifikuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mosaplikimi i garancionit bankar për një pjesë të konsumatorëve komercialë

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, nenet 32 dhe 37 përcaktojnë natyrën kontraktuale të marrëdhënies së furnizimit në tregun e liberalizuar. Po ashtu, Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve garanton lirinë e kontraktimit ndërmjet palëve. Në përputhje me rregullat e ZRRE dhe kushtet e licencës së furnizuesit, aplikimi i garancionit bankar ose parapagimit përbën një mekanizëm të ligjshëm për menaxhimin e riskut kreditor dhe sigurimin e likuiditetit të furnizuesit.

Sipas kushteve kontraktuale të KEK, parapagimi ose garancioni bankar kërkohet për të mbuluar periudhën ndërmjet furnizimit me energji dhe pagesës së faturës nga konsumatori, si dhe për të kompensuar obligimet e paguara në rast të ndërprerjes së kontratës.

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja ka nënshkruar kontrata furnizimi me konsumatorë komercialë, me një numër që varion nga 128 deri në 166 kontrata. Megjithatë, në 32 raste nuk është aplikuar garancioni bankar apo parapagimi, pavarësisht se kjo kërkesë është e përcaktuar në kushtet kontraktuale si një masë për menaxhimin e riskut kreditor.

Mosaplikimi i garancionit bankar në këto raste për të gjithë klientët lidhet me mungesën e një zbatimi të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të kushteve kontraktuale, si dhe me mungesën e mekanizmave efektivë të monitorimit nga menaxhmenti.

Ndikimi

Si rezultat, ndërmarrja është ekspozuar ndaj riskut të shtuar kreditor për një pjesë të konsumatorëve komercialë, duke rrezikuar mospagesën e faturave dhe krijimin e llogarive të paarkëtueshme. Kjo ndikon në likuiditetin e ndërmarrjes dhe mund të çojë në humbje financiare në rast të mosinkasimit të detyrimeve.

Rekomandimi A1

Bordi Drejtues të sigurojë zbatim të plotë dhe të njëtrajtshëm të kushteve kontraktuale për aplikimin e garancionit bankar ose parapagimit për të gjithë konsumatorët komercialë. Po ashtu, të vendosen kontrolle të brendshme dhe mekanizma monitorimi për të siguruar që çdo devijim nga kjo praktikë të jetë i arsyetuar, i dokumentuar dhe i miratuar në mënyrë formale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Mungesë e dokumentimit në vlerësimin dhe ndarjen e tepricave të energjisë për tregtim në bursë/ankande**Gjetja**

Sipas Procedurës për Tregtimin e Energjisë nr. 8071/1, Neni 17 - Tregtimi përmes bursave (ALPEX), vendimmarrja rreth ndarjes së sasive që do të tregtohen përmes bursës ALPEX apo bursave të tjera dhe ankandit duhet të bazohet në tërë sasinë për tregtim, likuiditetin e bursës, përfitimin ekonomik për ndërmarrjen, të dhënat historike të tregtimit, kapacitetet ndërkufitare dhe indikatorë të tjerë që mund të ndikojnë në kërkesat afatshkurtra dhe afatgjata për tregtim, duke respektuar afatet kohore të detyrueshme për secilën platformë të tregtimit.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se ndërmarrja pas pranimit të raportit të KOSTT mbi tepricat e energjisë, nuk ka arritur të dokumentoj vendimmarrjen rreth ndarjes së sasive që do të tregtohen përmes bursës ALPEX/bursave tjera dhe ankandit, e cila sipas procedurave të brendshme duhet të bëhet përmes procesin e vlerësimit duke u bazuar në kriteret: sasia për tregtim, likuiditeti i bursës, përfitimi ekonomik për ndërmarrjen, të dhënat historike të tregtimit, kapacitetet ndërkufitare dhe indikatorë të tjerë që mund të ndikojnë në kërkesat afatshkurtra dhe afatgjata për tregtim.

Mos dokumentimi i vlerësimit kishte ndodhur për shkak të moszbatimit të plotë të kërkesave të procedurës për tregtim të energjisë dhe mungesës së një procesi të strukturuar për dokumentimin e analizave dhe vendimmarrjes brenda afateve të përcaktuara.

Ndikimi

Mos dokumentimi rrit rrezikun për vendimmarrje jo të bazuar në analiza të plota dhe të verifikueshme, duke rrezikuar arritjen e përfitimit optimal ekonomik për ndërmarrjen, si dhe krijon mungesë transparence dhe gjurmueshmërie në proces.

Rekomandimi A2

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit dhe ndarjes së tepricave të energjisë për tregtim të dokumentohet në mënyrë të plotë dhe të strukturuar, duke përfshirë të gjitha analizat relevante sipas kërkesave të Procedurës për Tregtimin e Energjisë. Po ashtu, duhet të vendosen kontrole të brendshme dhe afate të qarta për dokumentimin e vendimmarrjes, në mënyrë që të garantohet transparenca, gjurmueshmëria dhe respektimi i plotë i rregullave në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Mungesa e dispozitave të mjaftueshëm të kontrollit të brendshëm dhe mungesa e gjurmueshmërisë së komunikimit elektronik në procesin e ankandeve

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm në financa publike, neni 5, Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik (përfshirë ndërmarrjet publike) ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit të subjektit, dhe për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, politikave, strategjive, programeve, aktiviteteve dhe proceseve që ndërlidhen me zbatimin e tyre.

Sipas Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike nr. 8071/1, Neni 2 - Objekti dhe Qëllimi, ndërmarrja duhet të përcaktojë parimet e përgjithshme të shitjes, blerjes dhe shkëmbimit të energjisë elektrike dhe të garantojë mënyra efikase dhe praktike të tregtimit, prokurim ekonomik, promovim të konkurrencës, transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

Gjithashtu në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira, sistemet që mbështesin procese dhe transaksione kritike duhet të sigurojnë gjurmë të besueshme auditimi dhe të funksionojnë në platforma të sigurta dhe të mbështetura nga prodhuesi. Sipas ISO/IEC 27001 (Aneksi A - Regjistrimi dhe monitorimi i ngjarjeve dhe Kontrolli i qasjes), sistemet duhet të mundësojnë regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve, përjashtimeve dhe ngjarjeve të sigurisë, si dhe të sigurojnë që qasja në asetet kritike të informacionit të jetë e gjurmueshme dhe e kontrolluar.

Procesi i tregtimit të tepricave të energjisë është i bazuar në Procedurën për Tregtimin e Energjisë Elektrike (theksuar më lartë) dhe realizohet përmes bursave dhe/apo ankandeve. Kjo procedurë përcakton hapat dhe rrjedhën e procesit të tregtimit, mirëpo nuk përmban dispozita të mjaftueshme lidhur me monitorimin sistematik dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm për këto aktivitete. Megjithatë ndërmarrja gjatë vitit 2024 kishte përcaktuar një lokacion të veçantë për tregtimin e energjisë të pajisur me kamera mbikëqyrëse, me qëllim të pamundësisë së tregtimit nga lokacione tjera dhe kufizon qasjen vetëm në persona të autorizuar.

Nga testimet tona kemi identifikuar se procesi i ankandit për tregtimin e energjisë realizohet përmes një adrese elektronike (e-mail) të menaxhuar në platformën Microsoft Exchange Server 2010, e cila ka arritur fundin e ciklit të mbështetjes nga prodhuesi dhe nuk përfiton më përditësime të sigurisë dhe kibernetike. Gjithashtu është evidentuar mungesa e gjurmëve të auditimit, pasi kutia postare e përdorur për pranimin e ofertave nuk ka të aktivizuara regjistrimet e aktiviteteve të përdoruesve (audit logs). Si rrjedhojë, sistemi nuk regjistron kohën e hapjes së email-it dhe as identitetin e përdoruesit, duke pamundësuar verifikimin e saktë të kohës zyrtare të hapjes së ankandit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e procesit, gjatë vitit 2022-2023 ndërmarrja ka zhvilluar një sistem të ri, i cili është vendosur menjëherë në testim nga përdoruesit fundorë pa kaluar në testim teknike nga departamenti i TI-së dhe nuk është vënë asnjëherë në përdorim. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar dy procedura të prokurimit për marrjen me qira të një platforme alternative, por procedurat kishin dështuar për shkak se nuk është pranuar asnjë ofertë.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i mungesës së një kornize të plotë për monitorim dhe kontrolle të brendshme në procesin e tregtimit të energjisë, e shoqëruar me menaxhim të pamjaftueshëm të sistemeve të TI-së dhe mungesë të zgjidhjeve të qëndrueshme teknologjike, përfshirë mosfunksionalizimin e sistemit të ri dhe dështimin e sigurimit të një platforme alternative përmes prokurimit.

Ndikimi

Mungesa e dispozitave të mjaftueshme për monitorim dhe kontrolle të brendshme, e shoqëruar me përdorimin e një platforme të vjetruar pa gjurmë auditimi, mosfunksionalizimin e sistemit të ri, si dhe dështimin e sigurimit të një platforme alternative përmes prokurimit, ka ndikuar në vazhdimin e procesit të tregtimit në kushte të njëjta, pa përmirësim të kontrollit dhe gjurmueshmërisë.

Rekomandimi A3

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë rishikimin e procedurës për tregtimin e energjisë duke siguruar dispozita të mjaftueshme lidhur me monitorimin sistematik dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm për aktivitetet e tregtimit të energjisë.

Gjithashtu, duhet të merren masa në TI për forcimin e integritetit, transparencës dhe sigurisë në tregtimin e energjisë, përmes përdorimit të një platforme me gjurmë auditimi, kontroll të qasjes dhe monitorim të aktiviteteve. Po ashtu, të vlerësohet dhe përmirësohet sistemi ekzistues i TI-së përmes testimeve dhe certifikimit të pavarur, ndërsa nëse ai nuk është i përshtatshëm, të zhvillohet ose prokurohet një zgjidhje alternative e qëndrueshme dhe e përditësuar. Deri atëherë, rekomandojmë të forcohen kontrollet e brendshme ekzistuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B4 - Zbatim i procedurave të negociuara pa publikim për shkak të mangësive në procedurat e rregullta

Gjetja

Sipas nenit 35.2 të Ligjit për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurë të negociuar pa publikim paraparak vetëm në raste emergjente ekstreme, të shkaktuara nga ngjarje të paparashikueshme dhe të verifikueshme, për të cilat nuk mund të jepet koha e nevojshme për procedurat e zakonshme. Kjo nuk vlen nëse emergjenca është rezultat i veprimeve neglizhente apo të qëllimshme apo lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja kishte lidhur kontrata të negociuara si në vijim: tri kontrata për Furnizim me Acid Klorhidrik (31-33%), në vlerë komulative 240,030€ dhe tri kontratat për Furnizim me Lëndë Djegëse - Mazut, në vlerë komulative 1,404,465€.

Ky veprim ishte rezultat i pamundësisë për të finalizuar procedurat e hapura të prokurimit nga ankesat e ofertuesve të Autoriteti Kontraktues dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit, që nga shqyrtimi i të cilave janë evidentuar mangësitë në vijim:

- Në aktivitetin e prokurimit për Furnizim me acid klorhidrik (31-33%), procedura kishte dështuar për shkak se ndërmarrja sipas vlerësimit të OSHP-së kishte vendosur kriter diskriminues lidhura me standardin EN 939:2016, i cili aplikohet për acid klorhidrik për trajtimin e ujërave të pijshëm dhe nuk duhet të kërkohet për trajtim të ujërave industrial. Megjithatë në një procedurë të negociuar të prokurimit ndërmarrja kishte ftuar për negociim më shumë se një operator ekonomik.
- Në aktivitetin e prokurimit Furnizim me Lëndë Djegëse - Mazut, kemi identifikuar se prokurimi është kategorizuar me disa ankesa gjatë viteve 2024-2025, kthim në rivlerësim të procedurës disa herë nga OSHP, lidhur me mangësitë që ishin identifikuar në dosjen e tenderit (p. Sh. si: parametrat si: vlera kalorifike 9500 kcal/kg, dendësia 0.95 kg/dm³ dhe përmbajtja e hirit max 0.2% janë përcaktuar pa toleranca), qoftë nga OSHP dhe nga komisioni i rivlerësimit. Vlenë të theksohet se autoriteti kontraktues me datën 03.12.2025 kishte marrë vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit. Megjithatë në dy procedura të negociuar të prokurimit ndërmarrja kishte ftuar për negociim më shumë se një operator ekonomik.

Kjo kishte ndodhur për shkak se dosjet e tenderit nuk ishin përgatitur plotësisht sipas kërkesave të LPP-së. Si rrjedhojë e saj proceset janë ballafaquar me ankesa dhe për pasoj janë zhvilluar procedura të negociuara pa publikim.

Ndikimi

Mos lidhja e kontratës përmes procedurave të rregullta dhe shtyrja e vazhdueshme e përmbylljes së aktivitetit të prokurimit për furnizim me acid klorhidrik dhe mazut ka ndikuar që ndërmarrja të lidhë gjashtë kontrata të negociuara pa publikim. Meqenëse aktivitetet përkatëse ende nuk janë finalizuar, ekziston rreziku real për lidhjen e kontratave të tjera të negociuara në vijim.

Rekomandimi B4

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që të bëhet një analizë e plotë e të gjitha rrethanave që kanë çuar në situatën aktuale dhe të ndërmerr veprime e duhura në mënyrë që dosjet e tenderëve të jenë të përgatitura në harmoni të plotë me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Vendosja e kriterëve në dosje të tenderit jo në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik**Gjetja**

Sipas nenit 25.13 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik me plotësim/ndryshime, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Operatori Ekonomik të dëshmojë që në përputhje me nenin 69 të LPP-së, në të kaluarën ka përfunduar kontrata të një natyre të ngjashme me një vlerë të caktuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, e cila nuk mund të caktohet më shumë se 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës. Kjo nënkupton se Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesën për qarkullim specifik nëse ka përfunduar një apo disa kontrata të një natyre të ngjashme që vetëm ose sëbashku arrijnë totalin e vlerës së specifikuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe nuk kërkohet që kjo kërkesë në vlerën e përcaktuar prej 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës të plotësohet vetëm me një kontratë të vetme të asaj vlere.

Në tri aktivitete të prokurimit, ndërmarrja kishte përfshirë në dosje të tenderit si kriter edhe kërkesat mbi kapacitetet teknike dhe profesionale, duke kërkuar që operatorët ekonomikë të ofrojnë projektet e realizuara brenda 3 viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Megjithatë kemi vërejtur se kjo kërkesë nuk ishte aplikuar në përputhje me kërkesat ligjore, pasi që në rastet kur aplikohet, duhet të specifikohet edhe vlera e kontratës së realizuar, e cila nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Kjo kërkesë ishte aplikuar në procedurat e prokurimit: "Asfaltimi-riparimi i rruges Mirash, hyrja 09 deri te garderoba ne Grabovce", "Riparimi komplet i pompës qarkulluese dhe motorit ngasës elektrik" dhe "Furnizim me gazra industrial".

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së duhur të vëmendjes gjatë vendosjes së kriterëve në dosjen e tenderit.

Ndikimi

Vendosja e kriterëve jo në harmoni me kërkesat ligjore mund të ndikon që procesi i vlerësimit të ofertave të mos jetë objektiv, madje mund të shpie tek lidhja e kontratës me operatorët ekonomikë që nuk ka kapacitet teknike reale për realizimin e kontratave përkatëse.

Rekomandimi A4

Bordi i Drejtorëve të siguroj se vendosja e kriterëve përkatëse bëhet në harmoni të plotë me kërkesat të ligjit të prokurimit publik në mënyrë që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë i qartë dhe i drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A5 - Mangësi në procedurën e pranimi të furnizimeve dhe dokumentimit**Gjetja**

Sipas nenit 72A të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022 me plotësim ndryshimet, Komisioni për pranimin e furnizimeve duhet të jetë në përbërje prej jo më pak se tre anëtarëve nga ekspertë të fushës përkatëse, duke përfshirë edhe menaxherin e kontratës. Komisioni për pranimin e furnizimeve është përgjegjës të bëjë konstatimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës së furnizimeve të pranuar, të cilat dokumentohen me procesverbal se janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhër blerjen.

Nga auditimi i menaxhimit të kontratës për procedurën “Furnizim me gazra industrial” dhe verifikimi i 12 faturave në vlerë 25,666€, është identifikuar se në asnjë rast të mostrave të testuara menaxheri i kontratës nuk ishte pjesë e komisionit për pranimin e furnizimeve, dhe si rrjedhojë nuk ka aprovuar përputhshmërinë e tyre me kontratën apo urdhërblerjen. Po ashtu, në këto dëshmi mungon konfirmimi se malli i pranuar është furnizuar nga prodhuesi i deklaruar dhe i certifikuar sipas standardeve ISO, të kërkuara në dosjen e tenderit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë dhe mosrespektimit të kërkesave ligjore të procedurave të përcaktuara për menaxhimin dhe pranimin e furnizimeve.

Ndikimi

Kjo ndikon në uljen e besueshmërisë së procesit të pranimi dhe rrit rrezikun që furnizimet të pranohen pa verifikim të duhur të përputhshmërisë me kontratën dhe standardet e kërkuara.

Rekomandimi A5

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që përbërja e komisioneve për pranimin e furnizimeve të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, duke përfshirë menaxherin e kontratës, si dhe të garantojë që çdo pranim i mallit të aprovohet dhe dokumentohet në mënyrë të plotë, duke dëshmuar përputhshmërinë me kontratën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative gjatë këtij viti janë në shumën 202,010,704€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e zhvlerësimit, shpenzimet e pagave, shpenzimet e energjisë elektrike dhe komunali, shpenzimet e mirëmbajtjes, materialeve dhe furnizimeve, shpenzimet e linjtit, provizionet, shpenzimet e shtyra të prodhimit të energjisë si dhe shpenzimet tjera operative.

Çështja B5 - Përdorimi i shpeshtë i procedurës me vlerë minimale

Gjetja

Sipas neneve 16,17 dhe 18 të Ligjit për Prokurimin Publik, autoritetet kontraktuese nuk duhet të zgjedhin ose përdorin metoda të vlerësimit apo të strukturimit të kërkesave që synojnë zvogëlimin e vlerës së kontratës për furnizime, shërbime apo punë, në mënyrë që ato të bien nën kufijtë e përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji. Po ashtu, ndalohet ndarja e kërkesës për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve apo shërbimeve me qëllim të anashkalimit të këtyre kufijve financiarë.

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja kishte zhvilluar disa procedura të ndara të prokurimit për të njëjtat kategori të furnizimeve brenda të njëjtit vit kalendarik.

- Ndërmarrja kishte nënshkruar gjashtë kontrata për furnizim me kushineta, në vlerë totale 56,198€. Tri prej këtyre kontratave kanë pasur vlerë më të ulët se 1,000€, përderisa katër prej tyre janë lidhur me të njëjtin operator ekonomik.
- Sipas planit të prokurimit të vitit 2025, ndërmarrja kishte paraparë një procedurë të prokurimit për furnizim me ngjites, ndërsa gjatë vitit kishte nënshkruar 10 kontrata në vlerë prej 84,972€. Nga kontratat e lidhura, tetë ishin nënshkruar me të njëjtin operator ekonomik.
- Ndërsa sa i përket Furnizimit me toner, ndërmarrja kishte nënshkruar pesë kontrata, në vlerë totale 3,048€, katër prej të cilave kanë pasur vlerë më të ulët se 1,000€, edhe përkundër planit të prokurimit në i cili ka të planifikuar furnizimin përmes një procedure të prokurimit.

Për më tepër, sipas raportit të kontratave të nënshkruara, ndërmarrja kishte realizuar edhe gjashtë lloje të tjera furnizimesh, përmes 28 procedurave të veçanta të prokurimit, me një vlerë totale prej 351,164€ përfshirë: dhëmb për lugë të eskavatorëve, motorrë sharre Stihl MS 361, brusha dhe mbajtës të brushave, servisimi, kalibrimi dhe çertifikimi i peshores, Inventar për zyre dhe furnizim dhe montim me kondicioner.

Qasja jo strategjike në prokurim ka ardhur si rezultat i mungesës së koordinimit dhe planifikimit të nevojave nga njësitë kërkuuese.

Ndikimi

Zhvillimi i shumë aktiviteteve të prokurimit me vlerë të vogël e ngarkon kapacitetin operativ të zyrës së prokurimit dhe ulë efikasitetin e saj. Kjo praktikë mund të çënojë economicitetin, pasi çmimet për sasi më të vogël mund të jenë më të larta krahasuar me blerjet në sasi më të mëdha.

Rekomandimi B5 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se kërkesat nga njësitë kërkuese të grupohen në mënyrë që të zhvillohen aktivitete të prokurimit që sigurojnë konkurrencë më të lartë dhe çmime më ekonomike. Për të shmangur përsëritjen e aktiviteteve të prokurimit, ndërmarrja duhet t'i grumbullojë nevojat në mënyrë që të jetë më efikase dhe më ekonomike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit për modulën e kontratave

Gjetja

Neni 81 i LPP përcakton se autoritet kontraktuese duhet që si pjesë e përgatitjes së aktivitetit të prokurimit të prodhojnë një plan të menaxhimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratave. Plani i menaxhimit duhet të jetë i rënë dakord midis palëve të kontratës dhe të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës. Ndërsa, sipas nenit 70 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022, të gjithë zyrtarët/personat e caktuar/emëruar si menaxherë të kontratës si nga ana e AK dhe OE duhet të bëjnë administrimin dhe manaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me manualët për përdorim të modulit për menaxhimin e kontratës. Gjithashtu, vlerësimi i përformacës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të përformancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualët për përdorim të modulit për vlerësimin të përformacës së kontraktuesve.

Ne kemi identifikuar se ndërmarrja në tri procedura të prokurimit nuk kishte vendosur planet e menaxhimit të kontratës në platformën elektronike të prokurimit dhe në 12 raste tjera menaxhimi i kontratave nuk është zhvilluar përmes moduleve përkatëse të platformës elektronike të prokurimit. Gjithashtu, edhe procesi i vlerësimit të kontratave nuk është zhvilluar përmes modulit të prokurimit publik.

Mangësitë e identifikuar kanë ardhur si pasojë e mungesës së trajnimit të personelit përgjegjës dhe kujdesit të pamjaftueshëm në trajtimin e kërkesave ligjore gjatë vitit 2025, pavarësisht faktit se në fund të vitit, Zyra e Prokurimit ka nxjerrë urdhëresë për fillimin e zbatimit të tyre.

Ndikimi

Mos vendosja e planeve të menaxhimit të kontratave, mos shfrytëzimi i modulit për menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e përformacës së kontraktuesve përmes sistemit e-prokurimi, ndikon që kontratat të mos mbikëqyren në kohë reale.

Rekomandimi A6

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që hartimi i planeve të menaxhimit të kontratave, menaxhimi i tyre dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve të realizohen përmes platformës së e-prokurimit, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Sistemet Informative

Në këtë fushë është përfshirë fillimisht monitorimi i implementimit të rekomandimeve të vitit paraprakë që lidhen me Teknologjinë Informative në KEK sh.a., përderisa sipas vlersimit ky fushveprim u zgjerua me qëllim të identifikimit të sigurisë së informacioneve në veprimtaritë kryesore të ndërmarrjes.

Çështja B6 - Qasja e përdoruesve përmes rrjetit privat virtual (VPN)

Gjetja Sipas Politikës së sigurisë së informacionit, para se të ju lejohej qasja të punësuarve në rrjetin virtual privat - VPN të ndërmarrjes, duhet të kërkohej plotësimi i formularit të veçantë për aplikim të qasjes në VPN, që vërteton kërkesin e qasjes, aprovimin e mbikëqyrësit për qasje, zotimin e përdorimit të pajisjeve në pronësi dhe të menaxhuara nga TI e ndërmarrjes, si dhe mbrojtjen e integritetit të informacioneve dhe rrjetit të ndërmarrjes.

Nga krahasimi i qasjeve të lejuara përmes rrjetit privat virtual (VPN) me formularët e veçantë për aplikimin e qasjeve, nga 25 qasje të lejuara, në dy prej tyre nuk është respektuar plotësisht "Politika e sigurisë së informacionit", pasi që në formularët që vërtetojnë kërkesin e qasjes, aprovimin e mbikëqyrësit për qasje, zotimin e përdorimit të pajisjeve në pronësi dhe të menaxhuara nga TI e ndërmarrjes, si dhe mbrojtjen e integritetit të informacioneve dhe rrjetit të ndërmarrjes, edhe pse ishte plotësuar formulari me të dhënat për zyrtarët që kishin qasje në VPN, mungonin aprovimet për këto dy qasje të lejuara nga mbikëqyrësi.

Llogaritë të cilat nuk kishin të plotësuar aprovimin në formular për qasje në VPN i takonin menaxhmentit të lartë, prandaj nuk e kishin parë të nevojshme aprovimin e tyre, edhe pse janë plotësuar informatat për qasje nga vetë ata dhe janë nënshkruar, përmes formularit të paraparë me politikën e sigurisë së informacionit.

Ndikimi Zbatimi i formularit për qasje në VPN rrit kontrollin e qasjeve në rrjetin e brendshëm të ndërmarrjes, mirëpo çdo përjashtim i kontrollit të qasjes është ekspozim për sigurinë e informacionit.

Rekomandimi B6 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se politika e sigurisë së informacionit në ndërmarrjes. për qasjen përmes VPN duhet të zbatohet për të gjithë punonjësit duke kontrolluar qasjen e tyre në VPN përmes formularëve për lejimin e qasjes për të gjithë punonjësit pa përjashtim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1	Paraqitja e gabuar e garancionit bankar si llogari e arkëtueshme dhe depozitave të klientëve në pasqyrat financiare
Gjetja	Në kuadër të zërit “Llogari të arkëtueshme tjera”, ndërmarrja ka paraqitur garancionin bankar në vlerë prej 5,200,000€, i cili përfaqëson depozitë të bllokuar në bankë dhe nuk përbën të drejtë arkëtimi ndaj KOSST sh.a., që rrjedhimisht kishte reflektuar edhe në shpalosje jo të drejtë në shënimet shpjeguese. Gjithashtu, ndërmarrja mban depozita të klientëve në formë garancie për pagesa dhe tregtim, të cilat përfaqësojnë mjete të kufizuara dhe nuk janë të disponueshme për përdorim të lirë, të cilat nuk janë shpalosur në mënyrë adekuate si para të kufizuara.
Veprimi i kërkuar	Rekomandohet që menaxhmenti të ndërmarrë veprime korrigjuese me prioritet për adresimin e çështjeve të lartcekura, me qëllim që PFV-të të pasqyrojnë gjendjen e drejtë dhe të vërtetë financiare të institucionit.
Rezultati	Pas pranimit të shkresës sonë, institucioni ka ndërmarrë veprimet e nevojshme duke korrigjuar dhe shpalosur në mënyrë të plotë dhe të saktë informacionet përkatëse në Pasqyrat Financiare Vjetore.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat financiare të vitit 2024 ka rezultuar në tetë rekomandime. Ndërmarrja kishte përgatitur planin e veprimit, në të cilin kishte paraqitur rekomandimet që do t'i zbatojë, si dhe veprimet që do të ndërmerre. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, dy rekomandime ishin zbatuar dhe gjashtë rekomandime nuk ishin zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në grafikun dhe tabelën në vijim:

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë përditësimin e regjistrin të pasurisë me gjendjen aktuale duke prezantuar saktë dhe drejtë pasurinë afatgjatë të ndërmarrjes në pasqyrat financiare vjetore.	Menaxhmenti nuk kishte përditësuar regjistrin e pasurisë, duke mos pasqyruar në mënyrë të saktë dhe të përditësuar gjendjen aktuale të pronave të paluajtshme të ndërmarrjes.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që pasuritë e regjistruara sipas modelit të rivlerësimit të rivlerësohen në frekuenca të rregullta dhe të arsyeshme sipas kërkesave të standardeve, në mënyrë që vlera e prezantuar në pasqyrat financiare dhe jeta e tyre e mbetur të reflektojnë vlerën e drejtë në fund të çdo periudhe raportuese, duke shmangur devijime materiale. Për më tepër, të përcaktohet vlera dhe jeta e mbetur e pasurive të mbajtura me kosto fillestare zero.	Përveç rivlerësimit të klasës së pasurisë “tokat oborr” të realizuar në vitin 2023, ndërmarrja gjatë vitit 2024 nuk ka zbatuar rivlerësim për klasat e tjera të pasurisë që mbahen sipas modelit të rivlerësimit, si: tokat dhe pyjet për nxjerrjen e thëngjillit, objektet, impiantet, makineritë dhe pajisjet e prodhimit.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të realizohet në përputhje me kërkesat ligjore. Pas vlerësimit të të gjitha rezultateve dhe miratimit të raportit përfundimtar të inventarizimit, të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin e rezultateve me librat kontabël.	Nga rishikimi i procesit të inventarizimit të pasurive, si dhe harmonizimit me shënimet kontabël, gjatë auditimit është identifikuar se edhe këtë vit nuk është bërë në përputhje me kërkesat ligjore.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të bëhet një analizë e plotë e të gjitha rrethanave që kanë çuar në situatën aktuale dhe të identifikojë mangësitë që po e detyrojnë ndërmarrjen të lidhë kontrata përmes procedurës së negociuar. Po ashtu, duhet të sigurojë që vlerësimi i ofertave nga komisionet përkatëse dhe rishikimi nga zyra e prokurimit të realizohen me kujdes, duke garantuar një proces të drejtë, transparent dhe të paanshëm dhe me qëllim të lidhjes së kontratave përmes procedurave të hapura.	Ndërmarrja ka vazhduar me zhvillimin e procedurave të prokurimit, duke aplikuar procedura të negociuara pa publikim në mënyrë jo të rregullt dhe me mangësi në përputhje me kërkesat ligjore.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që, në rast të angazhimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore, të shmangen shpenzimet e panevojshme për shërbime të njëjta, duke respektuar parimin e përdorimit efikas dhe ekonomik të fondeve publike.	Ndërmarrja ka zbatuar rekomandimin e dhënë nga viti paraprak.	I zbatuar

6.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet të kryhen në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe të zhvillohen procedura adekuate sipas kërkesave të Ligji për Prokurimin Publik, duke garantuar respektimin e parimeve të transparencës, konkurrencës dhe menaxhimit të drejtë dhe efikas të fondeve publike.	Janë ndërmarrë masat për të ndaluar vazhdimin e furnizimit sipas kësaj marrëveshjeje, dhe nga testimet nuk rezultoi të ketë pasur përsëritje të transaksioneve të ngjashme.	I zbatuar
7.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se kërkesat nga njësit kërkuese të grupohen në mënyrë që të zhvillohen aktivitete të prokurimit që sigurojnë konkurrencë më të lartë dhe çmime më ekonomike. Për të shmangur përsëritjen e aktiviteteve të prokurimit, ndërmarrja duhet t'i grumbullojë nevojat në mënyrë që të jetë më efikas dhe më ekonomik.	Përmes testimit të mostrave është konstatuar se ndërmarrja edhe këtë vit ka vazhduar me përdorimin e shpeshtë të procedurave me vlerë minimale, duke përsëritur çështje të mëparshme.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Sistemet Informative	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj zbatimin e politikës së sigurisë së informacionit në ndërmarrje, duke siguruar që para se të lejohet qasja e të punësuarve në rrjetin virtual privat - VPN të ndërmarrjes, të bëhet plotësimi i formularit të veçantë për qasje. Për më tepër të plotësohen formularët e pa plotësuar edhe për të gjitha qasjet aktive në rrjetin virtual privat VPN.	Ndërmarrja nuk plotësuar formularët e aprovuar për të gjitha qasjet në VPN, sipas procedurave.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Xhemile Berisha - Hoti, Udhëheqëse e ekipit



Lindita Ajeti, Anëtare e ekipit



Alban Shatri, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Qasja e përdoruesve përmes rrjetit privat virtual (VPN)	<p>KEK nuk pajtohet me këtë gjetje: Çasjet në VPN, janë dhënë duke u bazuar në politikat e sigurisë së IT-së, si dhe formularëve për qasje. Formularët për qasje në VPN, janë aprovuar sipas kërkesës së formularit - aprovimi bëhet nga Drejtori përkatës i Divizionit ose Mbikqyrësi.</p> <p>Për nivelin e Menaxhmentit të lartë të ndërmarrjes, mjafton vetëm kërkesa e plotësuar për VPN, e nënshkruar nga vet ai, pasi që të njëjtit i raportojnë organit më të lartë të ndërmarrjes (Bordit të Drejtorëve) dhe sipas përgjegjësise, menaxhmentit i është besuar menaxhimi i kompanise, pra është hierarkia me e larte e saj, ndersa Bordi i Drejtoreve nuk merr vendime te natyres operative dhe në përgjegjesi te vetë menaxhmentit.</p>	<p>Pavarësisht komenteve të ndërmarrjes, gjetja qëndron, pasi procesi i dhënies së qasjeve në VPN duhet të jetë i standardizuar dhe i dokumentuar në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha nivelet e organizatës, duke siguruar kontrolle të brendshme dhe gjurmueshmëri të plotë të aprovimeve në përputhje me politikat e sigurisë së IT-së. Për më tepër, formularët për qasje në VPN nuk përfshijnë vetëm menaxhmentin e lart, megjithatë çështja ka të bëjë me raste të izoluara.</p>
Mos përditësimi i regjistrit të pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme	<p>KEK nuk pajtohet me interpretimin që sugjeron se asetet të cilat figurojnë vetëm juridikisht në emër të Korporatës duhet të njihen në pasqyrat financiare, pavarësisht mungesës së kontrollit dhe përfitimeve ekonomike. Një qasje e tillë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet themelore të raportimit financiar sipas IFRS. Sipas Kornizës Konceptuale për Raportimin Financiar (paragrafët 4.3-4.6), njohja e një asemi kërkon në mënyrë kumulative:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ekzistencën e një burimi ekonomik; • kontrollin nga ana e entitetit mbi atë burim; dhe • pritjen e përfitimeve ekonomike të ardhshme. <p>Në mungesë të kontrollit dhe përfitimeve ekonomike, këto elemente nuk përmbushen dhe rrjedhimisht njohja e tyre si asete do</p>	<p>Pavarësisht veprimeve të ndërmarrjes dhe sqarimeve të ofruara, gjetja qëndron, pasi regjistri i pasurive të paluajtshme vazhdon të mos pasqyrojë plotësisht dhe saktë gjendjen faktike dhe juridike të pronave, sipas kriterëve të përcaktuara SNK 16 për trajtimin si dhe pasqyrimin e sakte të pasurive të ndërmarrjes, përfshirë edhe kërkesat e SNK 1 lidhur me shpalojsen e drejtë dhe të saktë të tyre.</p> <p>Për më tepër, shpjegimi/komentimi i vet ndërmarrjes pasqyron që çështja e pronave në gjetje është e evidente edhe për institucionin.</p>

të ishte jo vetëm e pasaktë, por edhe në shkelje të drejtpërdrejtë të IFRS. Në rastin konkret:

- KEK nuk ushtron kontroll faktik mbi këto prona;
- nuk ka të drejtë reale për përdorim apo përfitim ekonomik;
- dhe nuk ka aftësi për të kufizuar aksesin e palëve të treta;

Po ashtu, sipas SNK 16, njohja e pasurive nuk bazohet në formën ligjore të pronësisë, por në substancën ekonomike dhe kontrollin. Vetë fakti që një aset figuron në emër të KEK nuk krijon automatikisht të drejtë për njohje në pasqyrat financiare nëse mungon kontrolli dhe përdorimi ekonomik. Është thelbësore të theksohet se KEK ka zbatuar në mënyrë rigoroze parimin e “substancës mbi formën”, duke mos i njohur këto asete në libra, por duke i shpalosur në mënyrë të plotë dhe transparente në shënimet shpjeguese, duke përmbushur kështu kërkesat për informim të palëve tjera.

KEK mban qëndrimin e qartë se:

- mosnjohja e këtyre aseteve është e vetmja qasje e saktë sipas IFRS;
- trajtimi aktual siguron paraqitje të drejtë dhe të besueshme;
- dhe kjo çështje nuk përbën dhe nuk mund të përdoret si bazë për kualifikim të opinionit të auditimit.

Për më tepër, kompania ka shpalosur në detaje në shënimin shpjegues nr.4 të pasqyrave financiare çështjet pronësore dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme dhe në kompetencë të menaxhmentit, në të cilat janë të përfshira edhe palët tjera.

Po ashtu, për asetet të cilat janë në regjistrin e aseteve afatgjatë të ndërmarrjes dhe për të cilat ka paqartësi në bartjen/tjetërsimin e pronësisë tek një palë tjetër, Menaxhmenti dhe Bordi Drejtorëve kanë vlerësuar që këto prona të jenë pjesë e regjistrit të aseteve deri në një vendim përfundimtar gjyqësor.

Çështjet pronësore:

Për pronën në Prishtinë (1.72 ha):

KEK ka pranuar historikun nga AKK-ja dhe Ndërmarrja Publike Banesore (NPB), ku dëshmohet se prona në fjalë i takon KEK.sh.a., e fituar përmes procedurave të shpronësimit kohë më parë. Lidhur me këtë, në vitin 2025 kemi ushtruar padi civile me masë sigurie pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës kundër "Prishtina Parking" dhe Komunës së Prishtinës, andaj pa nje vendim te plotfuqishem gjyqesore nuk mund te nderrmerren veprime konkrete. Lidhur me lokalin afarist 140 m²: Ky lokal është liruar pjesërisht. Në vitin 2024 kemi ekzekutuar vendimin gjyqësor të Gjykatës Komerciale ndaj të paditurës "Gazeta Epoka e Re", duke arritur lirimin e zyrave që kishin në posedim. Megjithatë, e njëjta palë ka zënë pjesën tjetër të objektit, për çka kemi ndërmarrë masa të reja ligjore (kallëzim penal dhe padi civile) gjatë vitit 2024. Në vitin 2025 jemi informuar nga Prokuroria Themelore e Prishtinës se ndaj Uzurpatorit janë në shqyrtim të lendes për mundesin e ngritejes se Aktakuzes. Deri në një epilog përfundimtar, kompania do ta shpalesë këtë aset si pa kontroll të plotë mbi të. Procedurat gjyqesore jane ne procesë. Andaj pa nje vendim te plotfuqishem gjyqësor nuk mund të ndërmerren veprime konkrete.

Për pesë parcelat në Komunën e Podujevës: Situata mbetet e njëjtë; asetet janë të evidentuara në regjistrin e kompanisë (si dhe në fletat poseduese deri në vitin 2007). Jemi ende në proces gjyqësor pas padisë së ushtruar ndaj dy palëve të tjera dhe jemi në pritje të vendimit të gjykatës. Behet fjalë për parcelat : Par.nr.531, zk.Sallabajë; Parc.nr.404/2 dhe 418, zk.Sibovc i Poshtëm; Parc.nr.744, zk.Sibovc i Poshtëm; Parc.nr.1346, 2471, 2472,2473,2474,2475, zk.Gllamnik; Parc.nr.2834, 2835, 2836, 2837 2839, zk.Podujevë. Andaj pa nje vendim te plotfuqishem gjyqesore nuk mund te nderrmerren veprime konkrete.

Lidhur me tokën në Vasilevë (55.7

	<p>ha): Jemi në proces gjyqësor me palën që figuron pronare sipas certifikatës. Në fund të vitit 2025, kemi dërguar urgjencë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega Glllogoc, me kërkesën që kjo çështje gjyqësore të përshpejtohet dhe të hyjë sa më parë në procedurë. Në fund të vitit 2025, kemi dërguar urgjencë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega Glllogoc, me kërkesën që kjo çështje gjyqësore të përshpejtohet dhe të hyjë sa më parë në procedurë. Andaj pa nje vendim te plotfuqishem gjyqësore nuk mund te nderrmerren veprime konkrete.</p>	
<p>Dobësi në prezantimin e pasurive afatgjata, përfshirë trajtim të ndryshëm të pasurive të ndërmarrjes</p>	<p>Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) nuk pajtohet me konkluzionin se ekziston mospërputhje materiale apo devijim nga standardet ndërkombëtare të kontabilitetit lidhur me trajtimin e pasurive afatgjata. Politika kontabël e KEK për pasuritë, impiantet dhe pajisjet është e bazuar në mënyrë të qartë në SNK 16 - modeli i kostos, i cili është një nga dy modelet e lejuara nga standardi (SNK 16, paragrafi 29). Standardi nuk obligon entitetin të aplikojë modelin e rivlerësimit, por kërkon që politika e zgjedhur të zbatohet në mënyrë konsistente për klasat e pasurive, gjë që KEK e ka respektuar.</p> <p>Rivlerësimi i kategorisë së tokave në vitin 2023 përbën një përjashtim të justifikuar dhe të lejuar nga standardi (rivlerësimin e një kategorie specifike të asetëve), pasi toka si kategori ka natyrë të ndryshme dhe nuk i nënshtrohet zhvlerësimit (SNK 16, paragrafi 58). Ndërkohë, për kategoritë tjera të pasurive, vendimi për të vazhduar me modelin e kostos është plotësisht në përputhje me standardin dhe reflekton një qasje konservative dhe të qëndrueshme në raportim financiar. Vetë SNK 16 nuk kërkon rivlerësim periodik nëse aplikohet modeli i kostos, dhe rrjedhimisht mungesa e rivlerësimeve të mëtejshme nuk përbën devijim nga standardi. Sa i përket pasurive të zhvlerësuar</p>	<p>Pavarësisht sqarimeve të ofruara, gjetja qëndron, pasi që regjistri i pasurive afatgjata përmban pasuri të cilat ndër vite ishin trajtuar sipas modeleve të ndryshme (përjashtuar kategorinë e tokave) që është në kundërshtim me kërkesat e Kornizës Konceptuale për Raportim Financiar (paragrafët 2.12-2.14), SNK 16 (paragrafët 29,37 dhe 51) si dhe paragrafi D5 i SNRF 1. Konkretisht, një pjesë e pasurive trajtohen sipas modelit të kostos, një pjesë sipas modelit të rivlerësimit (përjashtimisht tokat), ndërsa pavarësisht deklarimit se pasqyrat financiare janë në përputhje me kërkesat e SNRF-ve, për një numër të caktuar të pasurive nuk është përcaktuar vlera fillestare në mungesë të dokumentacionit mbështetës dhe si rrjedhojë ato vazhdojnë të raportohen me vlerën zero në libra.</p>

plotësisht, por ende në përdorim, kjo është një situatë e zakonshme dhe e njohur në praktikën ndërkombëtare dhe nuk është në kundërshtim me standardet. Sipas SNK 16, paragrafi 55 dhe 56, zhvlerësimi bazohet në vlerësimin e jetës së dobishme dhe nuk nënkupton domosdoshmërisht se pasuria nuk ka më vlerë ekonomike ose nuk mund të përdoret. Përkundrazi, fakti që këto pasuri vazhdojnë të gjenerojnë të hyra tregon se ato janë operacionalisht funksionale (për të cilat regjistrohen shpenzime të mirëmbajtjes operative) dhe paraqet konsistencë të njohjes së të hyrave në raport me shpenzimet, ndërsa mbajtja e tyre me vlerë zero kontabël reflekton thjesht konsumimin e plotë të kostos historike dhe jo një pasaktësi në raportim.

Lidhur me pasuritë pa kosto historike të identifikueshme, duhet theksuar se SNRF 1 (paragrafi D5) aplikohet vetëm në momentin e tranzicionit fillestar në IFRS dhe nuk krijon obligim të vazhdueshëm për rivlerësim apo përcaktim të vlerës së drejtë për çdo periudhë raportuese. Në rastin e KEK, shumica e këtyre pasurive janë historike dhe të integruara në sistem përmes proceseve të mëhershme të inventarizimit dhe konsolidimit të të dhënave, dhe mungesa e kostos së dokumentuar nuk nënkupton automatikisht kërkesë për rivlerësim të detyrueshëm.

Sa i përket pretendimit për mungesë konsistence në trajtim, theksojmë se KEK ka aplikuar në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente të njëjtën politikë kontabël për pasuritë afatgjata që nga viti 2004 (gjatë korporatizimit të ndërmarrjes është përcaktuar/vlerësuar vlera fillestare e aseteve sipas të cilave është bërë regjistrimi në librat e aseteve), në përputhje me kërkesat e SNK 16 (modeli i kostos për klasat përkatëse të pasurive). Nuk ka pasur aplikim selektiv apo ndryshim të politikave brenda së njëjtës klasë të pasurive. Dallim i identifikuar lidhet me natyrën dhe karakteristikat e ndryshme të

	<p>kategorive të pasurive (p.sh. toka kundrejt pajisjeve dhe infrastrukturës), të cilat trajtohen si klasa të veçanta sipas standardit, por në asnjë rast nuk reflekton devijim nga politika kontabël e përcaktuar apo mungesë të konsistencës në zbatim.</p> <p>Përkundrazi, trajtimi i pasurive ka qenë i qëndrueshëm në kohë dhe në përputhje me kornizën e aplikuar të raportimit financiar.</p> <p>KEK vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • politika kontabël e aplikuar është në përputhje të plotë me SNK 16 • mbajtja e pasurive me kosto historike dhe zhvlerësimi i tyre deri në zero është praktikë e lejuar dhe e zakonshme • mungesa e rivlerësimeve të mëtejshme nuk përbën devijim nga standardet • çështjet e ngritura nuk ndërlidhen me pasaktësi materiale në pasqyrat financiare prandaj kjo gjetje nuk paraqet baze për kualifikim të opinionit. 	
<p>Mangësi në trajtimin, raportimin dhe pasqyrimin kontabël të rezultateve të inventarizimit vjetor</p>	<p>KEK nuk pajtohet me konkluzionin se ekzistojnë mangësi substanciale në trajtimin, raportimin dhe pasqyrimin kontabël të rezultateve të inventarizimit. Vlerësojmë se kjo gjetje nuk reflekton në mënyrë të drejtë realitetin operacional dhe kompleksitetin e proceseve në një ndërmarrje të natyrës së KEK.</p> <p>Procesi i inventarizimit në KEK është realizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat e brendshme, ndërsa diferencat e identifikuara nga komisionet nuk përbëjnë automatikisht mangësi në kontabilitet, por janë pjesë normale e një procesi verifikimi fizik në një sistem me volum shumë të madh dhe kompleksitet të lartë të pasurive dhe stoqeve.</p> <p>Është e rëndësishme të theksohet se harmonizimi i rezultateve të inventarizimit nuk është një proces mekanik dhe i menjëhershëm, por kërkon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • verifikim teknik të detajuar • analizë të dokumentacionit historik • dhe vendimmarrje të strukturuar në 	<p>Pavarësisht sqarimeve të dhëna nga ndërmarrja dhe përpjekjeve për përmirësim të tyre, procesi i inventarizimit nuk ka rezultuar në harmonizim të plotë ndërmjet të dhënave të raporteve të njëjësive, elaboratit përfundimtar dhe evidencave kontabël, sipas nenit 12 të Ligjit nr.06/L-032 për inventarizimin si dhe harmonizimin me librat kontabël. Mos kryerja e plotë e procesit të inventarizimit sipas kërkesave ligjore ndikon në besueshmërinë e informacionit financiar dhe papajtueshmëri ligjore. Prandaj, gjetja qëndron.</p>

nivel institucional

Çdo veprim kontabël pa përfundimin e këtyre hapave do të përbënte rrezik më të madh për pasaktësi, sesa vetë vonesa në harmonizim.

Sa i përket mos-çregjistrimit të pasurive: Pretendimi se pasuritë nuk janë harmonizuar për shkak të mosveprimit nuk qëndron.

Çregjistrimi i pasurive është një vendim me ndikim të drejtpërdrejtë në pasqyrat financiare dhe, si i tillë, është kompetencë ekskluzive e Bordit të Drejtorëve.

Fakti që Bordi nuk ka aprovuar çregjistrimin nuk mund të interpretohet si mangësi në kontabilitet apo në procesin e inventarizimit, por është:

- ushtrim i kompetencave të tij ligjore dhe qeverisëse
- respektim i parimeve të kontrollit të brendshëm
- dhe shmangie e vendimeve të nxituara pa analizë të plotë

Çdo çregjistrim i kryer pa vendim formal të Bordit do të përbënte shkelje serioze të kontrollit financiar dhe qeverisjes korporative.

Sipas Ligjit për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim, nr.06/L-032, neni 12:

12.1 Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

12.2 Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Pra, KEK pas aprovimit të Elaboratit të inventarizimit vjetor (dhe elaboratit plotësues) nga Bordi i Drejtorëve ka bërë harmonizimin e regjistrimit të pasurive dhe detyrimeve me raportin e inventarizimit.

Sa i përket banesave: Çështjet e identifikuar lidhur me banesat nuk përbëjnë mungesë trajtimi, por

reflektojnë kompleksitetin historik dhe juridik të kësaj kategorie të pasurive.

KEK ka aplikuar trajtim të vazhdueshëm dhe konsistent për këtë kategori, ndërsa:

- problemet me lokacionet
- përshkrimet standarde
- dhe dublikimet historike

KEK nuk pajtohet me konkluzionin se ekzistojnë mangësi substanciale në trajtimin, raportimin dhe pasqyrimin kontabël të rezultateve të inventarizimit. Vlerësojmë se kjo gjetje nuk reflekton në mënyrë të drejtë realitetin operacional dhe kompleksitetin e proceseve në një ndërmarrje të natyrës së KEK.

Procesi i inventarizimit në KEK është realizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat e brendshme, ndërsa diferencat e identifikuar nga komisionet nuk përbëjnë automatikisht mangësi në kontabilitet, por janë pjesë normale e një procesi verifikimi fizik në një sistem me volum shumë të madh dhe kompleksitet të lartë të pasurive dhe stoqeve.

Është e rëndësishme të theksohet se harmonizimi i rezultateve të inventarizimit nuk është një proces mekanik dhe i menjëhershëm, por kërkon:

- verifikim teknik të detajuar
- analizë të dokumentacionit historik
- dhe vendimmarrje të strukturuar në nivel institucional

Çdo veprim kontabël pa përfundimin e këtyre hapave do të përbënte rrezik më të madh për pasaktësi, sesa vetë vonesa në harmonizim.

Sa i përket mos-çregjistrimit të pasurive: Pretendimi se pasuritë nuk janë harmonizuar për shkak të mosveprimit nuk qëndron.

Çregjistrimi i pasurive është një vendim me ndikim të drejtpërdrejtë në pasqyrat financiare dhe, si i tillë, është kompetencë ekskluzive e Bordit të Drejtorëve.

Fakti që Bordi nuk ka aprovuar çregjistrimin nuk mund të interpretohet si mangësi në kontabilitet apo në procesin e inventarizimit, por është:

- ushtrim i kompetencave të tij ligjore dhe qeverisëse
- respektim i parimeve të kontrollit të brendshëm
- dhe shmangie e vendimeve të nxituara pa analizë të plotë

Çdo çregjistrim i kryer pa vendim formal të Bordit do të përbënte shkelje serioze të kontrollit financiar dhe qeverisjes korporative.

Sipas Ligjit për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim, nr.06/L-032, neni 12:

12.1 Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

12.2 Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Pra, KEK pas aprovimit të Elaboratit të inventarizimit vjetor (dhe elaboratit plotësues) nga Bordi i Drejtorëve ka bërë harmonizimin e regjistrit të pasurisë dhe detyrimeve me raportin e inventarizimit.

Sa i përket banesave: Çështjet e identifikuar lidhur me banesat nuk përbëjnë mungesë trajtimi, por reflektojnë kompleksitetin historik dhe juridik të kësaj kategorie të pasurive.

KEK ka aplikuar trajtim të vazhdueshëm dhe konsistent për këtë kategori, ndërsa:

- problemet me lokacionet
- përshkrimet standarde
- dhe dublikimet historike

janë rezultat i sistemeve të mëhershme dhe mungesës së dokumentacionit të plotë ndër vite, dhe jo i ndonjë dështimi aktual në kontroll apo menaxhim.

Rregullimi i këtyre çështjeve kërkon:

- verifikim fizik
- verifikim juridik
- dhe koordinim ndërinstytucional

dhe si i tillë është proces që kërkon

	<p>kohë dhe nuk mund të trajtohet në mënyrë të menjëhershme pa rrezikuar saktësinë.</p> <p>Sa i përket stokut të çelikut: Pretendimi për mospërputhje në stokun e çelikut nuk është i qëndrueshëm pasi diferenca e identifikuar është analizuar, dokumentuar dhe trajtuar përmes plotësimit të elaboratit të inventarizimit, i cili është miratuar nga Bordi i Drejtorëve dhe mbi këtë bazë janë bërë regjistrimet kontabël përkatëse (dëshmi, kartela e artikullit).</p> <p>Pra, kjo çështje nuk përbën mangësi në trajtim, por një diferencë të identifikuar dhe të trajtuar përmes procedurave të rregullta dhe të aprovuara prandaj nuk mundet të shfaqet si gjetje.</p> <p>Asnjë nga çështjet e ngritura nuk përbën provë të një pasaktësie materiale në pasqyrat financiare, por lidhet me kohën dhe procesin e trajtimit, i cili është zhvilluar në përputhje me praktikën e mira të qeverisjes korporative dhe kontrollit të brendshëm.</p>	
<p>Paraqitja e gabuar e garancionit bankar si llogari e arkëtueshme dhe depozitave të klientëve në pasqyrat financiare</p>	<p>KEK nuk pajtohet me mënyrën e paraqitjes së kësaj çështjeje në raport, konkretisht me implikimin se korrigjimi i bërë është rezultat i rekomandimit të auditorit.</p> <p>Sqarojmë se trajtimi i garancioneve bankare dhe depozitave të klientëve është adresuar dhe korrigjuar nga vetë menaxhmenti në kuadër të procesit të rishikimit të pasqyrave financiare, si pjesë e përmirësimit të vazhdueshëm të prezantimit dhe shpalosjeve, dhe jo si rezultat i një rekomandimi specifik të auditorit.</p> <p>Kjo çështje është diskutuar me auditorin gjatë procesit të auditimit; megjithatë, pozicioni fillestar i auditorit nuk ka qenë plotësisht në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), veçanërisht në aspektin e klasifikimit dhe prezantimit të mjeteve të kufizuara. Menaxhmenti ka ushtruar gjykimin profesional të pavarur dhe ka aplikuar trajtimin kontabël në</p>	<p>Pavarësisht komenteve të ndërmarrjes, çështja mbetet në raportin e auditimit, pasi korrigjimet në trajtimin e garancioneve bankare dhe depozitave të klientëve janë bërë me kërkesë të menaxhmentit, pas diskutimit të çështjeve të identifikuara.</p>

	<p>përputhje me substancën ekonomike të transaksioneve dhe kërkesat për paraqitje të drejtë dhe të besueshme.</p> <p>Për më tepër, përfshirja e kësaj çështjeje në seksionin “çështje të identifikuar dhe të korrigjuara gjatë auditimit” krijon një perceptim të pasaktë se ekzistonte një pasaktësi materiale e identifikuar nga auditori dhe e korrigjuar si rrjedhojë e ndërhyrjes së tij, gjë që nuk reflekton realitetin e procesit. Në fakt, bëhet fjalë për një përmirësim në prezantim dhe shpalosje, i iniciuar dhe zbatuar nga menaxhmenti. Në këtë kontekst, KEK vlerëson se kjo çështje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • nuk duhet të prezantohet si një gjetje auditimi; • nuk ka lindur si rezultat i një rekomandimi të auditorit; • dhe nuk duhet të përfshihet në raport si e tillë, pasi nuk reflekton drejt rolin e menaxhmentit dhe natyrën reale të korrigjimit. <p>Si rrjedhojë, kërkojmë që kjo çështje të hiqet nga raporti ose të riformulohet në mënyrë që të pasqyrojë saktë faktin që përmirësimi është bërë nga menaxhmenti në kuadër të rishikimit të brendshëm dhe jo si reagim ndaj një gjetjeje auditimi.</p>	
<p>Mosaplikimi i garancionit bankar për një pjesë të konsumatorëve komercialë</p>	<p>Gjatë periudhës raportuese 2025, NJQFEE është përballur me një dinamikë të lartë të lidhjes së kontratave me konsumatorët komercialë, si rezultat i zhvillimeve në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike dhe afateve të shkurtra operative për faktin se shumica e konsumatorëve (Duke refuzuar procesin e liberalizimit të tregut) nuk kanë dërguar kontratat dhe konfirmimet deri në ditën e fundit të skadimit të afatit 60 ditor si FMF, dhe atë pas përfundimit të orarit pas orës 16:00, ndërsa në anën tjetër presioni nga të gjithë palët e përfshira në këtë proces ka qenë që të vazhdojë kontinuiteti në sigurimin e furnizimit me energji elektrike.</p> <p>Në këtë periudhë, fokusi primar ka qenë realizimi në kohë i kontratave</p>	<p>Pavarësisht sqarimeve të ofruara nga ndërmarrja, gjetja qëndron. Nga auditimi është konstatuar se garancioni bankar nuk është aplikuar për të gjithë konsumatorët komercialë, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet kontraktuale të lidhura ndërmjet ndërmarrjes dhe konsumatorëve. Gjithashtu, bazuar në testimet e kryera gjatë auditimit, është evidentuar se konsumatorët që nuk kanë siguruar garancion bankar nuk kufizohen vetëm në ndërmarrjet publike. Për më tepër, dispozitat kontraktuale që rregullojnë detyrimin për sigurimin e garancionit bankar nuk parashohin përjashtim për asnjë kategori të konsumatorëve, andaj moszbatimi i këtij detyrimi nuk është i arsyetuar</p>

të furnizimit dhe garantimi i vazhdimësisë së furnizimit me energji elektrike për konsumatorët. Sa i perket ndikimit të rrezikut ekziston edhe një mekanizem sipas Rregullave për ndërrimin e Furnizuesit e leshuar nga ZRrE ku ne nenin 4. Njoftimi për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit ky rregull e mborn furnizusin e deritanishem dhe e kushtezon konsumatorin qe nuk mund te bej ndrrim te furnizusit pa permbushur obligimet sipas nenit 4.1 dhe 4.2 si ne vijim:

4.1 Brenda pesë (5) Ditëve të Punës nga pranimi i njoftimit të referuar në paragrafin 3.7, Furnizuesi i Deritashëm mund t'i dorëzoj AAM një njoftim për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit nëse Konsumatori ka dështuar të përmbush detyrimet e tij sipas nenit 36, paragrafit 5 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

4.2 Në qoftë se AAM pranon një njoftim për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit brenda kohës së specifikuar, atëherë AAM brenda dy (2) Ditëve të Punës, do ta njoftoj Furnizuesin e Ri për pranimin e njoftimit për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit duke dhënë arsyet e caktuara në njoftimin për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit.

Po ashtu, një pjesë e konsumatorëve për të cilët nuk është realizuar menjëherë garancioni bankar janë ndërmarrje publike dhe institucione me interes publik, përfshirë kompani të sektorit të telekomunikacionit, furnizimit me ujë dhe transportit publik, të cilat tradicionalisht kanë pasur kontinuitet në kryerjen e obligimeve financiare ndaj furnizuesit, perkunder sfidave të tyre me likuiditet, qe ka ndikuar direkt ne mospermbushjen e obligimit per parapagim. Në vlerësimin operacional dhe komercial të NJQFEE-së, edhe historiku i pagesave dhe natyra publike e këtyre konsumatorëve janë marrë në konsideratë gjatë procesit të menaxhimit të riskut kreditor.

në bazë të kushteve kontraktuale në fuqi, të cilat derivojnë nga Ligji nr.05/L-085 për Energji Elektrike si dhe Ligji nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

<p>Mungesë e dokumentimit në vlerësimin dhe ndarjen e tepricave të energjisë për tregtim në bursë/ankande</p>	<p>Korporata Energjetike e Kosovës nuk pajtohet me kete gjetje, pasi qe ekziston dokumentim i veprimeve. Gjatë vitit 2025 ndarjen e tepricave të energjisë për tregtim e ka mbështetur me Analizën e Tregtimit sipas dokumentit (mostër bashkëngjitur). Periudha kohore për ndarjen e sasive nga momenti i pranimit të dokumentit nga KOSTT është shumë e kufizuar, për shkak të kufizimit kohor maksimumi 10-15 minuta (në disa raste edhe më pak), është shumë e vështirë që të përgatitet dokumentacion më i kompletuar.</p>	<p>Pavarësisht sqarimeve të dhëna nga ndërmarrja dhe dëshmisë së prezantuar, gjetja qëndron për shkak se ndërmarrja nuk ka të dokumentuar procesin e vlerësimit dhe ndarjen e tepricave të energjisë për tregtim në bursë/ankande që sipas Procedurës për Tregtimin e Energjisë duhet të përfshijë vlerësimin e sasisë për tregtim, likuiditetin e bursës, përfitimin ekonomik për ndërmarrjen, të dhënat historike të tregtimit, kapacitetet ndërkufitare dhe indikatorë të tjerë për tregëtim.</p>
<p>Mungesa e dispozitave të mjaftueshëm të kontrollit të brendshëm dhe mungesa e gjurmueshmërisë së komunikimit elektronik në procesin e ankandeve</p>	<p>Duhet pasur parasysh që KEK ka ndërmarr të gjitha masat tjera, për kufizimin e qasjeve në vetëm kompjuterin e caktuar për tregtim, nga shfrytëzues të caktuar, pamundësisë së qasjeve përmes ActiveSync , OWA, POP3, IMAP . Sa i përket sigurisë së sistemit të emailit, ne përdorim Exchange Server 2010 (mailbox server), por e tërë siguria kibernetike, bazohet në TSME (Trellox Security for Microsoft Exchange), i cili i skanon të gjithë emailat që hyjnë nga jashtë, që dalin nga KEK si dhe komunikimin e brendëshëm me email. TSME është i licensuar, dhe i përditësuar në vazhdimësi.</p>	<p>Komenti i ofruar nga ndërmarrja nuk adreson çështjen e ngritur. Sa i përket sigurisë, çështja ndërlidhet me Microsoft Exchange 2010 që nuk ka përkrahje për shkak të mos përditësimit me versione të reja, gjë që edhe përditësimet e Trellox Security for Microsoft Exchange nuk mjaftojnë pasi që nuk është version që ofron siguri nga vet Microsoft që prej Tetorit 2020. Prandaj gjetja qëndron.</p>

<p>Zbatim i procedurave të negociuara pa publikim për shkak të mangësive në procedurat e rregullta</p>	<p>Lidhur me procedurat e prokurimit të theksuara në të gjeturën B4, duhet theksuar që këto procedura kanë filluar në vitin 2024, si dhe në këto dy procedura janë involvuar edhe institucione tjera relevante siç janë OSHP dhe në rastin e procedurës për mazut edhe Gjykata komerciale. Vlen të theksohet se aktiviteti i prokurimit me titull: Furnizim me Acid Klorhidrik është anuluar me dt. 27.06.2025 ku edhe pas dy kërkesave për rishqyrtim nga dy OE si dhe Ankesave në OSHP Vendimi I AK ka mbetur në fuqi. Ndërsa aktiviteti i prokurimit me titull Furnizim me lende djegëse për kaldaje- Mazut është anuluar me dt. 03.12.2025 po ashtu kemi pasur kërkesë për Rishqyrtim dhe Ankese në OSHP nga një OE por Vendimi AK ka mbetur në fuqi. Gjatë viti 2026 kemi filluar Procedurat e reja për të dy lendet Kontrata Kornize tri vjeçare dhe janë në proces të prokurimit. Këto dy lende janë bazike për funksionalizimin e prodhimit të Energjisë Elektrike në Termocentrale dhe njëkohësisht mungesa e këtyre lendeve do shkaktonte krize energjetike në vendin tonë. Perkunder që KEK ka përdorur procedurën e negociuar (e lejuar sipas LPP), ato janë inicuar me disa operatorë ekonomik për të pasur konkurrencë të drejtë duke bashkëpunuar edhe me MINT prej të ciles është marrë lista e të gjithë OE importojnë mazut në Republikën e Kosovës dhe të njejteve i është derguar ftesa për ofertë.</p>	<p>Sqarimet e dhëna kanë karakter përshkrues dhe nuk adresojnë apo kundërshtojnë çështjet e ngritura, prandaj gjetja qëndron.</p>
--	---	---

<p>Vendosja e kriterëve në dosje të tenderit jo në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik</p>	<p>Vendosja e kriterëve mbi kapacitetet teknike dhe profesionale është bere ne përputhje te plote me LPP-në përkatësisht nenin 69 si dhe legjislacionin detyësor për prokurim publik. Vendosja e këtyre kriterëve ka pasur për qëllim pjesëmarrje gjithëpërfshirëse duke mos kufizuar operator ekonomik potencial e qe është një nder parimet kryesore te prokurimit publik. Andaj Autoriteti kontraktues ka pasur per qëllim rritjen e konkurrencës. Pretendimi nga ZKA, lidhur me caktimin e vlerës i cili nuk duhet te tejkaloj shume prej 1.5 te vlerës se parashikuar te kontratës nuk ka karakter obligativ por i njëjti është opcional sipas vlerësimit te lendes se kontratës dhe ne legjislacion për prokurim nder te tjera qarte definohet se “Mund te përdoret” duke marrur kështu një karakter jo detyrues per AK.</p>	<p>Pavarësisht sqarimeve të dhëna, gjetja qëndron. Sipas legjislacionit në fuqi, autoriteti kontraktues mund (por nuk është i obliguar) të vendosë kriterë mbi kapacitetin teknik dhe profesional, megjithatë në rastet kur vendos të aplikojë kriterë të tilla, obligohet të respektojë kufizimet e përcaktuara me dispozitat përkatëse.</p>
--	--	---



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH. A.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D. O. O.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT / NATIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATUMI I PRANIMIT / DATE OF SUBMISSION: 20.05.2026			
Org. Jedis. / Org. Unit	Shif. Klasif. / Class. Code	Nr. Prot. / Prot. No.	Nr. Fajrove / No. Pages
05	47	815	1

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të “KEK” sh. a., për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe kemi komente për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Valdrin Krasniqi

Kryesues i Bordit të Drejtorëve të “Korporata Energjetike e Kosovës” SH. A.,

Data: 08/05/2026, Prishtinë,

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

20-04-2026

Nr. 2936
PRISHTINË - A



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Nr. 16/2026
Dt. 20.04.2026

Bordi i Drejtorëve i Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A.

Duke ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë ligjore konform Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe Ligjit Nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087, si dhe në mbështetje të dispozitave nga Rregulloret e Ndërmarrjes, neni 4 i kreut III që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, Bordi i Drejtorëve i emëruar me Vendim të QRK nr. 02/253, dt. 21.03.2025, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 20.04.2026, duke vepruar me kuorum dhe me votim njëzëri, mori këtë:

VENDIM

- I. Miratohet rishikimi i Raportit Vjetor të Korporatës Energjetike të Kosovës për vitin 2025.**
- II. Miratohen rishikimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të pa Audituarra për vitin 2025 si pjesë integrale të Raportit Vjetor.**

Arsyetime

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë ligjore për udhëheqjen e ndërmarrjes, si dhe në pajtim me kërkesat ligjore nga Ligji për Ndërmarrje Publike dhe ligje tjera relevante, Menaxhmenti i Korporatës Energjetike të Kosovës (tutje: KEK-Sh.A) sipas obligimit ligjor ka përpiluar dhe ka prezantuar para Bordit të Drejtorëve Raportin Vjetor për periudhën 01 Janar – 31 Dhjetor 2025 dhe atë së bashku me Draft Pasqyrat Vjetore Financiare të pa Audituarra për vitin 2025. Bordi i Drejtorëve në zbatim të nenit 31 paragrafi 31.3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, sipas obligimit ligjor me datë 16.03.2026 ka miratuar Raportin Vjetor të KEK-Sh.A për vitin 2025 dhe Pasqyrat Vjetore Financiare të pa audituarra të vitit 2025.

Menaxhmenti para Bordit të Drejtorëve ka propozuar rishikimin e Raportit Vjetor të KEK-SH.A për vitin 2025 dhe rishikimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të pa audituarra për vitin 2025, kjo si nevojë e përditësimeve në Pasqyrat Financiare me qëllim të përmirësimit të paraqitjes së drejtë dhe të besueshme të pozicionit financiar dhe performancës së Korporatës në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Këto përditësime përfshijnë riklasifikime të caktuara të asetëve dhe detyrimeve, me qëllim reflektimin më të saktë të natyrës dhe afatit të tyre, si dhe rritjen e konsistencës dhe krahasueshmërisë së informacionit financiar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve të lartshënuara, Bordi ka shqyrtuar dhe miratuar rishikimin e Raportit Vjetor të KEK-SH.A për vitin 2025 dhe rishikimin e Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2025 si material integruese si në dispozitiv të këtij vendimi.

Njëherësh, Bordi i Drejtorëve e autorizon Sekretarin e Korporatës që versionet zyrtare të rishikuara të Raportit Vjetor të KEK-Sh.A për vitin 2025 dhe Pasqyrat Vjetore Financiare të pa audituarra për vitin 2025 t'i dorëzojë te NJPMNP-ME apo në institucione tjera përkatëse sipas obligimit ligjor.

Vendimi hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit të tij.

Shtojcë: Rishikimi i Raportit Vjetor të Korporatës Energjetike të Kosovës për vitin 2025 dhe rishikimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të pa audituarra të vitit 2025.

I dërgohet:

1. Kryeshefit Ekzekutiv
2. Divizionit të Financave
3. Sekretaria e Ndërmarrjes
4. Arkivi KEK
5. NJPMNP-ME

Në emër të Bordit të KEK-sha
Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Valdrin Krasniqi



Datë
20.04.2026



Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.

**Pasqyrat Financiare për vitin që
përfundon më 31 Dhjetor 2025**

PËRMBAJTJA**FAQE**

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	4
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	5
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	6-50

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2025

	Shënimet	Më 31 Dhjetor 2025 (në EUR '000)	Më 31 Dhjetor 2024 (në EUR '000)
PASURITË			
Pasuritë afatgjata			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	281,144	267,524
Depozitat në banka - pjesa afatgjatë	10	-	48,000
Asetet e paprekshme	5	92	220
Asete të tjera afatgjata	6	6,400	600
Gjithsej Pasuritë afatgjata		287,636	316,344
Pasuritë afatshkurtra			
Stoqet	7	18,297	19,606
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera,neto	8	140,354	81,587
Paraja në dorë dhe në bankë	9	43,965	2,639
Depozitat në banka - pjesa afatshkurtër	10	132,600	169,005
Investimet në letra me vlere- afatshkurter	11	-	26,063
Asetet e tatimit të shtyrë		235	-
Të arkëtueshmet e shtyera të prodhimit të energjisë		42	-
Tatimi në të ardhura i arkëtueshëm		1,996	309
Gjithsej Pasuritë afatshkurtra		337,489	299,209
GJITHSEJ PASURITË		625,125	615,553
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti i aksionarëve			
Kapitali aksionar	12	25	25
Rezervat	13	208,454	208,338
Rezervat rivleresuese		44,728	44,728
Fitimet/(Humbjet) e akumuluar		175,266	165,163
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve		428,473	418,254
Detyrimet			
Detyrimet jo-qarkulluese			
Huamarrjet – pjesa afatgjatë	14	84,858	94,841
Grantet e shtyera	15	3,094	4,333
Provizionet	16	62,521	58,665
Detyrimet e shtyera tatimore	26	5,809	6,647
Gjithsej Detyrimet jo-qarkulluese		156,282	164,486
Detyrimet qarkulluese			
Huamarrjet– pjesa afatshkurtër	14	10,483	9,699
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	17	18,227	12,847
Tatimi ne te ardhura i pagueshem		-	1,539
Detyrimet e tjera afatshkurtëra	18	5,734	2,112
Të pagueshmet e shtyera të prodhimit të energjisë		-	100
Shpenzimet akruale	19	5,926	6,516
Gjithsej Detyrimet qarkulluese		40,370	32,813
Gjithsej Detyrimet		196,652	197,299
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		625,125	615,553

Këto pasqyra financiare të audituara janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve dhe të nënshkuara në emër të tyre më 17 Prill 2026:


Z. Gramos Hashani
 UD Kryeshef Ekzekutiv




Z. Gëzim Paci
 UD Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 7 deri 50 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

	Shënimet	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2025 (në EUR '000)	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2024 (në EUR '000)
Të hyrat nga shitja e rrymës	20	166,660	195,682
Të hyrat nga shitjet FEE	21	34,534	-
Të hyrat nga grantet	22	1,363	1,717
Të hyrat tjera	23	2,205	15,440
		204,762	212,839
SHPENZIMET OPERATIVE			
Zhvlërësimi dhe amortizimi	4,5	(37,639)	(48,341)
Shpenzimet e personelit	24	(57,902)	(50,850)
Energjia elektrike dhe komunalitë	25	(42,518)	(33,046)
Energjia e blerë për FEE	26	(32,588)	-
Shpenzimet e mirëmbajtjes		(3,142)	(3,110)
Materialet dhe furnizimet		(4,359)	(4,556)
Shpenzimet e linjtit	17	(20,851)	(24,324)
Provizionimet për shlyerjen e inventarit	7	182	935
Humbjet nga zhvlërësimi/Lirimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera		6,752	(2,708)
Ndryshimet në provizione	16	(4,684)	(3,722)
Shpenzimet e shtyera të prodhimit të energjisë		142	1,509
Shpenzimet e tjera operative	27	(5,775)	(6,282)
		(202,382)	(174,495)
Fitimi nga operacionet		2,380	38,344
Të hyrat / (Shpenzimet) financiare, neto	28	9,502	5,752
Fitimi para tatimit		11,882	44,096
Shpenzimet e tatimit në fitim	29	(1,779)	(4,972)
Fitimi neto për vitin		10,103	39,124
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Efekti i tatimit të shtyer në Huazimet - pjesa afatgjatë rivlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve	29	116	931
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		10,219	40,055

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 7 deri 50 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Pasqyra e ndryshimeve në Ekuitet

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

	Kapitali aksionar (në EUR' 000)	Rezervat (në EUR' 000)	Fitimet / (Humbjet) e akumuluar (në EUR' 000)	Rezerva e rivleresimit (në EUR' 000)	Gjithsej (në EUR' 000)
Gjendja më 01 Janar 2024	25	207,407	125,961	44,728	378,121
Fitimi për vitin			39,124		39,124
Korrigjimet e gabimeve			78		78
Kthimi i dëmtimit					
Rezerva e rivleresimit					
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		931			931
Total te hyra tjera gjithëpërfshirëse	-	931	39,202	-	40,133
Gjendja Me 31 Dhjetor, 2024	25	208,338	165,163	44,728	418,254
Gjendja me 01 Janar 2025	25	208,338	165,163	44,728	418,254
Fitimi për vitin			10,103		10,103
Korrigjimet e gabimeve					
Kthimi i dëmtimit					
Rezerva e rivleresimit					
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		116			133
Total te hyra tjera gjithëpërfshirëse	-	116	10,103	-	10,219
Gjendja Me 31 Dhjetor, 2025	25	208,454	175,266	44,728	428,473

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 7 deri 50 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

	Shënimet	Për vitin e mbyllur më 31.12.2025 (në EUR '000)	Për vitin e mbyllur më 31.12.2024 (në EUR '000)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Humbja(Fitimi) neto para tatimit		11,882	44,096
Rregullimet për zërat jomonetar			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	37,639	48,341
Amortizimi i granteve	19	(1,363)	(1,717)
Të hyrat nga interesi	24	(12,963)	(9,478)
Shpenzimet e interes	24	3,461	3,726
Provizionimi i borxheve të këqija	15	(6,752)	2,708
Provizionet per investime financiare		(272)	83
Provizionimi për kostot e mjedisit dhe pensioneve	15	191	3,722
Provizionimi për shlyerjet/kthimet e inventarëve	6	(182)	(935)
Rregullimi per energjinë e shkëmbyer		(142)	(1,509)
Pagesat e provizioneve gjyqesore		4,307	(2,483)
Provizionet tatimore		237	
Shlyerja e pronës, impianteve dhe paisjeve	4,5		22
Fitimi para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		36,043	86,576
Inventarët		1,491	585
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(50,569)	(27,237)
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		6,522	2,091
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		(6,513)	62,015
Interesi i arkëtuar		6,089	5,165
Interesi i paguar		(2,548)	(2,821)
Tatimi mbi të ardhura i paguar		(6,012)	(5,312)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		(8,984)	59,047
Paraja nga aktivitetet investive			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	4,5	(51,131)	(41,988)
Zvogëlim/(Rritje) në letra me vlerë		26,063	24,856
Zvogëlim/(Rritje) në depozita		84,405	(60,000)
Paraja (e përdorur) në aktivitetet investive		59,337	(77,132)
Paraja nga aktivitetet financiare			
Grantet e pranuar / (paguara) për importin e energjisë	14.1	124	(16,253)
Pagesa e huazimeve	13	(9,151)	(11,388)
Paraja (e përdorur) në aktivitetet financiare		(9,027)	(27,641)
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e parasë		41,326	(45,725)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		2,639	48,364
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	8	43,965	2,639

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 7 deri 50 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. ("Kompania" ose "KEK") është shoqëri aksionare inkuorporuar në Kosovë dhe e regjistruar nën Agjencinë e Regjistrimit të biznesit në Kosovë nën numrin e regjistrimit 70325399 (NUI: 811290808) me datë 27 dhjetor 2005. Kompania u transformua në një ndërmarrje aksionare (Sh.A.) nën Misionin e Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara ("UNMIK") rregullorja nr. 2001/6. Adresa e selisë qendrore së saj të regjistruar është: Rruga Nënë Tereza Nr. 36, 10 000 Prishtinë, Kosovë.

Kapital fillestar i regjistruar i Kompanisë arrin në 25 mijë euro. Librat e Kompanisë janë hapur që nga 1 janari 2005 bazuar në Raportin e Due-Diligence Financiare sipas dates 01 janar 2005 nga një vlerësues i pavarur.

Kompania është 100% në pronësi të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të Kompanisë janë gjenerimi energjise dhe aktivitetet minerare si nxerrja e linjtit duke përdorur termocentralet e tij.

Struktura aktuale operative e Kompanisë përbëhet nga zyra qendrore e korporatës dhe divizionet e mëposhtëm:

- Divizioni i prodhimit të Linjtit;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova A;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova B;

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova A për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2024 deri më 4 tetor 2026 (numri i licencës ERO / Li_05 / 17_A) nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Për shkak të paaftësisë së Kompanisë për të marrë Lejen e Integruar Mjedisore nga MMPH licenca për Kosovën A rinovohet çdo vit, ose çdo dy vite si ne këtë rast.

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova B për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2006 deri më 4 tetor 2026 (numri i licencës ERO / Li_05 / 17_B) nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Ndërsa më 13 prill 2017, Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A), Divizioni i Prodhimit "TC Kosova B", me numër licence ZRRE / Li_05 / 14_B, është modifikuar në "Licencë e Kogjenerimit të Energjisë Elektrike dhe Termike" me numër të ri licence ZRRE / Libp_05 / 17_B lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), të gjitha dispozitat e tjera të licencës së mëparshme mbeten në fuqi.

Ndërsa më 20 dhjetor 2018, Korporatës Energjetike të Kosovës ishte pajisur me licencën e re ERO/ Li_60 / 17 për Furnizim me Energji Elektrike me vlefshmëri nga 20 dhjetor 2018 deri më 19 dhjetor 2043.

Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SHA) gjatë dhjetorit 2014 filloi projektin për Kogjenerimin e Energjisë Termike ku energjia termike i shitet Termokos Sh.A me qëllim të sigurimit të furnizimit me ngrohje në Prishtinë.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB").

2.2 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç për Pronat, impiantet dhe pajisjet e blera para vitit 2005 të cilat mbahen me vlerë të drejtë, të cilat konsiderohen të jenë kosto në vitin e inkuorporimit.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

2.3 Supozimi i parimit të vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

2.4 Valuta funksionale dhe prezentimit

Valuta funksionale dhe raportuese e Kompanisë është euro (EUR) e cila është në pajtueshmëri me rregullativat e Unionit Monetar Europian dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, valuta euro është adoptuar si valutë e vetme legale në territorin e Kosovës që nga 1 janari 2002.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të deklaruara në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijëra euro, përveç nëse kërkohet të janë të shprehura ndryshe. Sipas nevojës, figurat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e prezantimit për vitin.

2.5 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet e denominuara në valuta ndryshe nga euro janë të regjistruara në kursin e këmbimit që vendoset në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të ndryshme nga euro, përfshihen në fitimin ose humbjen duke përdorur kursin e këmbimit që vendoset në atë datë.

Pasuritë dhe detyrimet të valutës monetare ndryshe nga euro përkthehen me kursin e këmbimit të tregut të mesëm në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në kurset e këmbimit pas datës së transaksionit njihen në fitim ose humbje pasi përkthimi i këmbimit valutor fiton më pak humbje.

2.6 Prona, impiantet dhe pajisjet

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve më 1 Janar 2005 janë riparuar me koston e konsideruar zvogëluar zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, ndërsa zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve të blera mbas periudhës 1 janar 2005 paraqiten me kosto zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, nëse ka.

Kostoja e konsideruar përfaqëson vlerat fillestare të pasurive të vlerësuara nga Kompania me ndihmën e një konsulentit të pavarur në kohën e shndërrimit nga një Korporatë në një Shoqëri Aksionare, më 1 janar 2005.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen fitimit ose humbjes gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Toka dhe pyjet mbahen sipas koston se vlerësuar dhe nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi në pasuritë e tjera është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë kostot e tyre ose shumat e rivlerësuara të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar, si vijon:

	2025	2024
Toka në mihje	6-10 vite	6-10 vite
Ndërtesat	10-50 vite	10-50 vite
Pajisjet e rënda industriale	10-50 vite	10-50 vite
Automjetet	10-50 vite	10-50 vite
Mobilje, armaturë dhe pajisje	10-50 vite	10-50 vite

Vlera e mbetur e pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar dhe rregulluar nëse ka qenë e përshtatshme, në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera bartëse e një pasurie është rritur menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e pasurisë është më e madhe se shumata e vlerësuar e rikuperueshme.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet nga shitja janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitim ose humbje.

2.7 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të kufizuar të cilat fitohen veçmas, mbarten me kosto zvogëluar amortizimin e akumuluar dhe humbje të akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet mbi baza lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësim, të cilat llogariten mbi bazën e ardhshme.

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të papërcaktuar që janë fituar veçmas, mbarten me kosto zvogëluar humbjet e akumuluar nga dëmtimi.

2.8 Mosnjohja e pasurive të paprekshme

Një pasuri e paprekshme nuk njihet në shitje ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi ose shitja. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një pasurie të paprekshme, maten si diferenca midis fitimit të asgjësimit neto dhe vlerës së mbartur të pasurisë, njihen në fitim ose humbje kur pasuria është çregjistruar.

2.9 Dëmtimi i pasurive jo - financiare

Në secilën datë të raportimit, Kompania rishikon vlerat kontabël të pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion që ato pasuri kanë pësuar një dëmtim nga humbjet. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet të përcaktojë masën e humbjes së dëmtimit (nëse ka). Kur pasuria nuk gjeneron fluks të parave që janë të pavarura nga pasuritë e tjera, Kompania vlerëson shumën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të parave të cilës i përket pasuria. Kur mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme e alokimit, pasuritë e korporatave u shpërndahen edhe njësive individuale të gjenerimit të parave, ose përndryshe ato shpërndahen në grupin më të vogël të njësive gjeneruese të parave për të cilat mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme të alokimit.

Shuma e rikuperueshme është më e lartë se vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara të parave zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për pasurinë për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parave nuk janë rregulluar.

Nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie (ose njësi gjeneruese të parave të gatshme) vlerësohet të jetë më e vogël se vlera e tij kontabël, vlera kontabël e pasurisë (ose njësia gjeneruese e parave të gatshme) zvogëlohet në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje, përveç nëse pasuria përkatëse mbahet me një shumë të rivlerësuar, në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si një rivlerësim dhe në atë masë që humbja e dëmtimit është më e madhe se teprica e rivlerësimit të lidhur, humbja e tepërt nga dëmtimi njihet në fitim ose humbje.

Kur një humbje nga dëmtimi shfuqizon më pas, vlera kontabël e një pasurie (ose njësia gjeneruese e parave të gatshme) është rritur në vlerësimin e rishikuar të shumës së rikuperueshme të tij, por në mënyrë që vlera e shtuar kontabël të mos kalojë vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar nuk do të kishte asnjë

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

humbje nga dëmtimi që do ishte njohur për pasurinë (ose njësinë gjeneruese të parave të gatshme) në vitet e mëparshme. Një kthim i humbjes nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje në atë mënyrë që eliminon humbjen nga dëmtimi i cili është njohur për pasurinë në vitet e mëparshme. Çdo rritje më të madhe se kjo shumë është trajtuar si një rritje të rivlerësimit.

2.10 Investimet në burimet minerale

Një entitet trajton pasuritë e kërkimit dhe vlerësimit si një klasë e veçantë të pasurive dhe jep informacionet shpjeguese të kërkuara nga SNK 16 Pronë, Impiante dhe SNK 38 Pasuritë e paprekshme.

Kompania i klasifikon pasuritë e kërkimit dhe vlerësimit si të prekshme ose të paprekshme sipas natyrës së pasurisë të fituar dhe aplikon klasifikimin në mënyrë të vazhdueshme.

Një pasuri e eksplorimit dhe vlerësimit nuk klasifikohet më si i tillë kur fizibiliteti teknik dhe qëndrueshmëria tregtare e nxjerrjes së një burimi mineral janë të demonstrueshme. Pasuritë e kërkimit dhe vlerësimit vlerësohen për dëmtim, dhe çdo humbje nga dëmtimi e njohur, para riklasifikimit.

Shpenzimet që njihen si pasuri kërkimore dhe vlerësuese përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në to:

- fitimi i të drejtave për të eksploruar;
- studime topografike, gjeologjike, gjeokimike dhe gjeofizike;
- shpimi eksplorues;
- gjurmimi;
- mostra; dhe
- aktivitete në lidhje me vlerësimin e fizibilitetit teknik dhe qëndrueshmërinë tregtare të nxjerrjes së një burimi mineral.

Investimet në burimet minerale janë shpalosur në shënimin 4, Prona, impiantet dhe pajisjet.

2.11 INSTRUMENTET FINANCIARE

Njohja dhe çregjistrimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare, ose atëherë kur bëhet transferimi i pasurive financiare dhe të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve thelbësore. Një detyrim financiar çregjistrohet atëherë kur ai shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç të arkëtueshmeve tregtare të cilat nuk përmbajnë në vete përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmim të transaksionit në pajtueshmëri me SNRF 15, të gjitha pasuritë e tjera financiare fillimisht maten me vlerë të drejtë, të korigjuar për kostot e transaksionit (aty ku është e zbatueshme). Pasuritë financiare, më përjashtim të pasurive financiare të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kosto të amortizuara.
- vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si FVOCI dhe (FVTPL).

Klasifikimi përcaktohet nga të dyja:

- Modeli i biznesit së njësisë ekonomike në menaxhimin e pasurisë financiare.
- Karakteristikat e rrjedhës së pasurisë kontraktuale të pasurisë financiare.

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare të cilat njihen në fitim ose humbje janë përfshirë brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve tregtare, të cilat paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

Matja e mëpasshme e pasurive financiare

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Pasuritë financiare maten me kosto të amortizuar atëherë kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë të përcaktuara si FVTPL):

- ato janë të mbajtura brenda një modeli biznesor, qëllimi i së cilit është mbajtja e pasurive financiare dhe grumbullimi i flukseve monetare kontraktuale.
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare prodhojnë flukse të mjeteve monetare, pagesa e kryegjësë dhe interesit, të shumës kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto pasuri maten me kosto të amortizuar përmes metodës efektive të interesit. Zbritja nuk aplikohet atëherë kur efekti i zbritjes është jo material. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera përfshihen tek instrumentet financiare.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes (FVTPL)

Pasuritë financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të grumbulluar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga pasuritë financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, llogariten në FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv.

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si (FVTPL).

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Kompania llogarit Pasuritë financiare në FVOCI nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektiv i të cilit është "të mbajë mbledhjen" e flukseve monetare të lidhura dhe të shesë dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse (OCI) do të riciklohet pas mosnjohjes së pasurisë.

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë pasuri financiar të kategorizuar si (FVOCI).

Zhvlerësimi i pasurive financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritura të kreditit - 'modelin e pritur të humbjes kreditore (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'. Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe Pasuritë e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe FVOCI, llogaritë e arkëtueshme, Pasuritë e kontratës të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe angazhimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Njohja e humbjeve të kreditorëve nuk është më e varur nga kompania që fillimisht identifikon një ngjarje të humbjes kreditorëve. Në vend të kësaj, kompania konsideron një gamë më të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjes së humbjeve të pritura kreditorëve, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit. Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte Pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit. '12 - mujore humbjet e pritshme të kredisë 'nihen për kategorinë e parë, ndërsa' humbjet e pritshme të kreditit të jetës' njihen për kategorinë e dytë. Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Kompania përdor një qasje të thjeshtuar në kontabilizimin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera dhe regjistron kompensimin për humbjet si humbjet e pritshme të kreditit të jetës. Këto janë mangësitë e pritura në flukset e mjeteve monetare kontraktuale, duke pasur parasysh potencialin e mosplotësimit në çdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Gjatë llogaritjes, kompania përdor përvojën e saj historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e ardhshëm për të llogaritur humbjet e pritshme të kredisë duke përdorur një matricë provizioni.

Kompania vlerëson zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare duke u bazuar në vlerësimin e menaxhmentit të humbjeve të pritshme të kredisë, duke marrë parasysh faktorë specifikë siç janë vjetërsia e bilancit, ekzistenca e mosmarrëveshjeve, modelet e pagesave historike të fundit dhe çdo informacion tjetër i disponueshëm në lidhje me besueshmërinë e palëve. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera janë të grupuara në bazë të të arkëtimit të kaluara dhe jo të kaluara. Referojuni tek shënimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera dhe Shënimit të Riskut Kreditor për një analizë më të detajuar se si zhvlerësimi është llogaritur.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë të pagueshmet tregtare, huazimet dhe shpenzimet akruale.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Kompania ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

2.12 Matja e vlerës së drejtë

Kur një pasuri apo detyrim, financiar apo jo-financiar, matet me vlerën e drejtë për njohje ose dhënie informacionesh, vlera e drejtë bazohet në çmimin që do të merrej për të shitur një pasuri ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësit e tregut në datën e matjes; dhe supozon se transaksioni do të bëhet ose: në tregun kryesor; ose në mungesë të një tregu kryesor, në një treg më të favorshëm.

Vlera e drejtë matet duke përdorur supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdorin kur çmimi i pasurisë ose detyrimit, supozohet se veprojnë në interesat e tyre më të mirë ekonomik. Për pasuritë jo-financiare, matja e vlerës së drejtë bazohet në përdorimin e saj më të lartë dhe më të mirë. Teknikat e vlerësimit që janë të përshtatshme për rrethanat dhe për të cilat të dhënat të mjaftueshme janë në dispozicion për të matur vlerën e drejtë, janë përdorur, duke maksimizuar përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizuar përdorimin e inputeve të paverifikueshme.

Pasuritë dhe detyrimet e matura me vlerën e drejtë klasifikohen në tre nivele, duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e inputeve të përdorura në bërjen e matjeve. Klasifikimet rishikohen në çdo datë raportimi dhe transferimet ndërmjet niveleve përcaktohen bazuar në rivlerësimin e nivelit më të ulët të inputit që është i rëndësishëm për matjen e vlerës së drejtë.

Për matjet e përsëritura dhe jo të përsëritura të vlerës së drejtë, vlerësuesit e jashtëm mund të përdoren kur ekspertiza e brendshme ose nuk është e disponueshme ose kur vlerësimi vlerësohet të jetë i rëndësishëm. Vlerësuesit e jashtëm zgjidhen bazuar në njohuritë dhe reputacionin e tregut. Kur ka një ndryshim të rëndësishëm në vlerën e drejtë të një pasurie ose detyrimi nga një periudhë në tjetrën, është ndërmarrë një analizë, e cila përfshin një verifikim të inputeve kryesore të përdorura në vlerësimin e fundit dhe një krahasim, kur është e aplikueshme, me burimet e jashtme të të dhënave.

2.13 Klasifikimi afatshkurtër dhe afatgjatë

Pasuritë dhe detyrimet janë të paraqitura në pasqyrën e pozitës financiare duke u bazuar në klasifikimin afatshkurtër dhe afatgjatë.

Një pasuri klasifikohet si afatshkurter kur: ose pritet të realizohet prej saj ose qëllimi është për t'u shitur ose për t'u konsumuar në ciklin normal operativ; mbahet për qëllime primare të tregtimit; pritet të realizohet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose pasuria është para apo ekuivalent i parasë përveç nëse ndalohet për t'u këmbyer apo për t'u përdorur për kryerjen e një detyrimi për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha pasuritë e tjera klasifikohen si afatgjata.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtër kur: ose pritet të kryhet në ciklin normal operativ; mbahet për qëllime primare të tregtimit; pritet të kryhet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose nuk ka të drejtë të pakushtëzuar për t'a shtyer kryerjen e detyrimit për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha detyrimet e tjera klasifikohen si afatgjata. Tatimi i shtyrë si pasuri dhe detyrime gjithnjë klasifikohet si afatgjatë.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

2.14 Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshinë paratë dhe gatshme, depozitat në të pare dhe investimet e tjera shumë likuide afatshkurtra të cilat janë lehtë të konvertueshme në një shumë të njohur të parave dhe janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerë.

2.15 Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare janë fillimisht të njohura me vlerën e drejtë dhe pastaj maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus ndonjë lejim për humbjet e pritura të kreditit. Të arkëtueshmet tregtare në përgjithësi janë për t'u kryer brenda 30 deri 60 ditë.

Kompania ka aplikuar një qasje të thjeshtuar për matjen e humbjeve të pritura të kreditit, që përdor një lejim për humbjet e pritura gjatë jetëgjatësisë. Për të matur humbjet e pritura të kreditit, të arkëtueshmet tregtare janë grupuar në bazë të ditëve të vonesës. Të arkëtueshmet tjera janë njohur sipas koston së amortizimit, minus ndonjë lejim për humbjet e pritura të kreditit.

2.16 Inventarët

Materialet, pjesët rezervë dhe të konsumit, kryesisht lidhen me termocentratin dhe minieren, dhe janë vlerësuar me koston më të ulët të dhe vleres neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e bëra në blerjen e inventarëve dhe sjelljen e tyre në vendin e tyre dhe kushtet aktuale. Vlera e realizueshme neto është cmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhen normale të biznesit, minus shpenzimet e aplikueshme variabile të shitjes. Materialet dhe pjesët rezerve shpenzohen apo kapitalizohen në pasurinë materiale të përshtatshme kur instalohen. Një provizion për inventar me levizje të ngadalshme dhe të vjetërsuara (përfshijë qymyrin dhe karburantet) njihet në fitim ose humbje, bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhmentit.

Linjiti: Kompania nxjerr linjitin e saj i cili është përdorur në procesin e prodhimit për gjenerimin e energjisë elektrike në termocentralet e saj, e cila punon në dy minierat. Rezervat e linjtit janë paraqitur në kosto, e cila përfshin koston direkte të nxjerrjes dhe një pjesë përkatese të shpenzimeve indirekte që janë shkaktuar me nxjerrjen e tij.

2.17 Huazimet

Kostot e huamarrjes që lidhet drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një pasurie të kualifikuar janë kapitalizuar gjatë periudhës kohore që është e nevojshme për të përfunduar dhe përgatitur pasurinë për qëllim përdorimi ose shitje, i shtohen kostot e atyre pasurive, deri në kohën kur pasuritë janë në thelb të gatshme për përdorimin ose shitjen e synuar të tyre.

Në atë masë që huazimet me normë të ndryshueshme përdoren për të financuar një pasuri të kualifikuar dhe mbrohen në një mbrojtje efektive të rrjedhës së parasë së rrezikut të normës së interesit, pjesa efektive e derivatit njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe riklasifikohet në fitim ose humbje kur pasuria kualifikues ndikon në fitimin ose humbjen. Në atë masë që huazimet e normës fikse përdoren për të financuar një pasuri të kualifikuar dhe mbrohen në një mbrojtje efektive të vlerës së drejtë të rrezikut të normës së interesit, kostot e huamarrjes së kapitalizuar reflektojnë normën e interesit të mbrojtur.

Të ardhurat nga investimet të fituara nga investimi i përkohshëm i huazimeve specifike në pritje të shpenzimeve të tyre për pasuritë kualifikuese, zbriten nga kostot e huamarrjes të përshtatshme për kapitalizim. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin.

2.18 Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Këto shuma përfaqësojnë detyrime për mallrat dhe shërbimet që i ofrohen kompanisë para fundit të vitit financiar dhe të cilat janë të papaguara. Për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ato maten me koston e amortizuar dhe nuk zbriten. Shumat janë të pasigurta dhe zakonisht paguhet brenda 30 ditëve nga njohja.

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

2.19 Detyrimet e kontratës

Detyrimet e kontratës përfaqësojnë detyrimin e kompanisë për të transferuar mallra ose shërbime te një klient dhe njihen kur një klient paguan shumën, ose kur kompania njih një të arkëtueshme për të pasqyruar të drejtën e saj të pakushtëzuar në konsideratë (cila është më e hershme) para se kompania të ketë transferuar mallrat ose shërbimet ndaj klientit.

2.20 Njohja e të hyrave

Kompania i njih të hyrat si më poshtë:

Të hyrat nga kontratat me klientët

Shitja njihet në shumën që reflekton vlerësimin për të cilën kompania prit të jetë e thirrur në shkëmbimin e të mirave apo shërbimeve te klienti. Për çdo kontratë me klient, kompania: identifikon kontratën me klientin; identifikon obligimet në kontratë; përcakton çmimin e transaksionit që merr në llogari vlerësimet e ndryshme dhe vlerën në kohë të parasë; alokon çmimin e transaksionit për detyrimet e veçanta në bazë të çmimit të shitjes së pavarur të çdo malli apo shërbimi që do të dërgohet; dhe njih të hyrat kur ose secili obligim është përfunduar në një mënyrë që përshkruan transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara.

Vlerësimet e ndryshme brenda çmimit të transaksionit, nëse ka, reflektojnë konçesionet të siguruara te klienti siç janë zbritjet, rabatet dhe rimbursimet, çdo bonus potencial i arkëtueshëm nga klienti dhe çdo ngjarje tjetër kontingjente. Vlerësimet e tilla përcaktohen duke përdorur ose metodën e 'vlerës së pritur' ose metodën e 'vlerës më të mundshme për të ndodhur'. Matja e vlerësimeve të ndryshme i nënshtrohet një parimi kufizues prej ku shitja do të njihet vetëm deri në shkallën që është shumë e mundshme që një kthim domethënës në vlerën e grumbulluar të shitjes nuk do të ndodhë. Vlerësimi i kufizuar vazhdon derisa pasiguria e shoqëruar me vlerësimin e ndryshëm zgjidhet më pas. Shumat e pranuar që i nënshtrohen parimit të kufizuar njihen fillimisht si të hyra të shtyra në formë të një detyrimi të ndarë rimbursues.

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike njihen kur u ofrohet energji elektrike konsumatorëve. Faturimi për shitjet e energjisë elektrike bëhet çdo muaj, brenda pesë (5) ditëve të muajit pas muajit në të cilin kryhet konsumi i energjisë elektrike.

Të ardhurat nga shitja e thëngjillit

Shitja e thëngjillit njihet në pikën e shitjes, e cila është aty ku klienti ka marrë dorëzimin e të mirave, rreziqet dhe shpërblimet transferohen te konsumatori dhe ekziston një kontratë e vlefshme shitje.

Interesi

E hyra nga interesi është njohur kur interesi ndodh duke përdorur metodën e interest efektiv. Kjo është një metodë e kalkulimit të kostos së amortizuar së një pasurie financiare dhe e alokimit të hyrave të interesit nëpër periudhën relevante duke përdorur normën e interesit efektiv, normë e cila saktësisht zbret pranimet e parasë të parashikuara përmes pritshmërisë së pasurisë financiare për vlerën neto kontabël të pasurisë financiare.

Qiraja

Të ardhurat nga qiraja njihen mbi bazën lineare gjatë afatit të qirasë. Motivet e dhëna me qira njihen si pjesë e të ardhurave nga qiraja. Qiraja e kontingjente njihet si e ardhur në periudhën kur fitohen.

Të ardhurat tjera

Të ardhurat tjera njihen kur pagesa pranohet apo kur e drejta për të pranuar pagesën është krijuar.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Të ardhurat nga jobalancat

Të ardhurat nga imbalancat (pozitive) krijohen në rastin kur realizimi i prodhimit për orë të caktuara tejkalon planifikimin e prodhimit dhe në sistem krijohet një imbalance pozitive (devijim) dhe në këto rrethana energjia shtyhet në sistem dhe faturohet si sasi të energjisë së devijuar shumëzuar me çmimin fiks për orë të aksioneve HUPEX shumëzuar me faktorin 0.7.

Të ardhurat nga Kogjenerimi

Të ardhurat nga shitjet e energjisë termike njihen kur energjia u jepet klientëve. Faturimi për shitjet e energjisë elektrike bëhet çdo muaj brenda pesë (5) ditëve të muajit pas muajit në të cilin kryhet konsumi i energjisë elektrike.

Të ardhurat nga shkëmbimi i energjisë

Shkëmbimi i energjisë elektrike bëhet për të mbështetur palët e përfshira në këtë marrëveshje (KEK dhe KESH) si në rastin e Importit apo edhe eksportit. Kur KEK-u ka teprica të energjisë elektrike që nuk mund t'i vendosë në treg, atëherë i kërkon KESH t'i depozitohet ato dhe anasjelltas, kur KESH ka teprica të energjisë elektrike për shkak të rritjes së nivelit të ujit, atëherë i kërkon KEK-ut që të depozitohet energji elektrike. Në raste të tjera kur secila palë është në gjendje emergjente dhe duhet të marrë energji nga pala tjetër, atëherë ia paraqet kërkesën palës tjetër me arsyeshmëri dhe kohëzgjatje. Për energjinë e shkëmbyer njihen shpenzimet e ndodhura sipas kostos mesatare të kalkuluar për MWh në periudhën relevante.

2.21 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë njohur në pasqyrën e të ardhurave pas pranimit të shërbimeve ose në momentin kur nododhin.

2.22 Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes kryesisht përbëhen nga interesi për huazimet e Kompanisë. Kostot e huamarrjes që lidhet drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një pasurie të kualifikuar janë kapitalizuar gjatë periudhës kohore që është e nevojshme për të përfunduar dhe përgatitur pasurinë për qëllim përdorimi ose shitjeje. Kostot e tjera të huamarrjes janë shpenzuar në periudhën në të cilën ato janë kryer dhe raportuar si "Kostot financiare".

2.23 Kostot e përfitimeve për pensione

Kontributet pensionale

Kompania nuk jep asnjë provizion dhe nuk ka asnjë detyrim për pensionet e punonjësve mbi dhe për kontributet e paguara në planin e pensionit të detyrueshëm të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

2.24 Tatimi

Tatimi është kalkuluar në pasqyrat financiare në përputhshmëri me ligjin aktual në fuqi të Kosovës mbi tatimet, Ligji nr. 06/L-105 "Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave". Norma e tatimit mbi të ardhurat e tatueshme të korporatave është 10%.

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

Tatimi aktual

Tatimi aktual llogaritet në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për vitin duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi siç raportohet në fitimin ose humbjen sepse përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe më tej përjashton zëra që nuk janë kurrë të tatueshëm ose të zbritshëm. Përgjegjësia e kompanisë për tatimin aktual llogaritet duke përdorur tarifatat tatimore që janë aprovuar në mënyrë thelbësore ose thelbësore deri në fund të periudhës së raportimit. Një provizion është e njohur për ato çështje për të cilat përcaktimi i tatimit është i pasigurt, por konsiderohet e mundshme që do të ketë një rrjedhje të ardhshme të fondeve tek një autoritet tatimor. Provizionet maten në vlerësimin më të mirë të shumës që pritet të paguhet. Vlerësimi bazohet në gjykimin e profesionistëve të tatimeve brenda Kompanisë bazuar në përvojën e kaluar me këto aktivitete dhe në raste të caktuara në bazë të këshillave të pavarur të këshillimit tatimor.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në ndryshimet midis vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës përkatëse tatimore të përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe llogariten për përdorimin e metodës së bilancit. Detyrimet tatimore të shtyra njihen përgjithësisht për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme dhe pasuritë tatimore të shtyra njihen në atë masë sa është e mundshme që fitimet e tatueshme do të jenë të disponueshme kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme. Vlera kontabël e pasurive tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe zvogëlohet në atë masë sa nuk është më e mundshme që fitimet e mjaftueshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të lejuar që të gjithë ose një pjesë e pasurisë të rikuperohet.

Tatimi i shtyrë llogaritet në normat e tatimeve që pritet të zbatohen në periudhën kur detyrimi shlyhet ose pasuria realizohet. Tatimi i shtyrë është ngarkuar ose kredituar për fitim ose humbje, përveç kur ka të bëjë me zërat e ngarkuar ose kredituar drejtpërdrejt në ekuitetin e vet, si PPE të rivlerësuar më parë të trajtuar si kosto e vlerësuar për kalimin në SNRF, në këtë rast tatimi i shtyrë gjithashtu trajtohet në ekuitet.

Matja pasuese e detyrimit tatimor të shtyrë llogaritet gjithashtu në ekuitet si të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar pasuritë tatimore aktuale ndaj detyrimeve tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me taksat e të ardhurave të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor dhe Kompania synon të shlyejë pasuritë dhe detyrimet e tanishme tatimore në baza neto. Kompania nuk e njeh pasuri tatimore të shtyrë në provizione duke përfshirë provizionin e arkëtueshme pasi konsideron se është për shkak të pasigurisë së trajtimit tatimor në periudhat e ardhshme.

Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin

Tatimi aktual dhe i shtyrë njihet në fitim ose humbje, përveç kur lidhet me zërat e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt me ekuitetin, në të cilin rast tatimi aktual dhe i shtyrë njihet edhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose të ardhura neto nga ekuiteti.

2.25 Grantet qeveritare

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ketë një siguri të arsyeshme që Kompania do të respektojë kushtet e bashkangjitura me to dhe që atëherë grantet do të merren.

Grantet qeveritare njihen në fitim ose humbje mbi baza sistematike gjatë periudhave në të cilat Kompania njeh si shpenzime kostot e lidhura për të cilat grantet kanë për qëllim të kompensojnë. Në mënyrë të veçantë, grantet qeveritare gjendja kryesore e të cilave është që Kompania të blejë, ndërtojë ose përvetësojë ndryshe pasuritë afatgjata (përfshirë pronën, impiantet dhe pajisjet) njihen si të ardhura të shtyra në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar dhe transferohen në fitim ose humbje në një bazë sistematike dhe racionale mbi jetën e dobishme të pasurive të lidhura.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet ose humbjet e bëra tashmë ose me qëllim të dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për Kompaninë pa kosto të lidhura me të ardhmen, njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

Përfitimi i një kredie qeveritare me një normë interesi nën atë të tregut trajtohet si një grant qeveritar, i matur si diferenca midis të ardhurave të marra dhe vlerës së drejtë të kredisë bazuar në normat e interesit mbizotërues të tregut.

Grantet qeveritare ndaj kostove të riedukimit të stafit njihen si të ardhura gjatë periudhave të nevojshme për t'i përputhur ato me kostot e lidhura dhe zbriten në raportimin e shpenzimeve përkatëse.

2.26 Tatimi mbi vlerën e shtuar

Të ardhurat, shpenzimet njihen neto nga shuma e tatimit mbi vlerën e shtuar, përveç kur tatimi mbi vlerën e shtuar nga blerja e pasurive ose shërbimeve nuk është e rimbursueshme nga organet tatimore, në të cilin rast vlera e shtuar është e njohur si pjesë e shpenzimeve për blerje ose si pjesë e kostos sipas rastit; dhe

Shuma neto e TVSH-së e cila është e rikuperueshme, ose që duhet paguar te autoritetet tatimore është përfshirë si pjesë e arkëtueshme ose detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar.

2.27 Ekuiteti

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përbëhet nga 25,000 aksione të zakonshme me 1 (një) euro për aksion. Aksionari i vetëm i Kompanisë është Qeveria e Kosovës.

Rezervat

Rezervat janë llogaritur fillimisht në librat e Kompanisë si diferencë midis kapitalit aksionar të regjistruar dhe vlerës së pasurive neto të Kompanisë siç përcaktohet nga vlerësimi i pavarur në datën e themelimit të saj si SH.A. (1 janar 2005). Këto rezerva hiqen në dispozicion të pasurive të lidhura. Më tej, këto rezerva nuk janë të disponueshme për shpërndarje tek aksionari.

Rezervat përfshijnë gjithashtu efektin e taksës së shtyrë (lëshimin e detyrimit tatimor të shtyrë) të krijuar fillimisht në bazë të rivlerësimit të pasurisë, bimëve dhe pajisjeve pas kalimit në SNRF.

Fitmet e mbajtura

Fitimet e mbajtura debitohen / kreditohen për humbjet ose fitimin e vitit.

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

2.28 Provizionet

Një provizion njihet kur Kompania ka një obligim aktual si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, dhe është e mundur se një rrjedhje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer obligimin, dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së obligimeve.

Shuma e njohur si provizion është vlerësimi më i mirë i vlerës së kërkuar për shlyerjen e detyrimit aktual në datën e raportimit, duke marrë parasysh rreziqet dhe paqartësitë rreth detyrimit. Kur një provizion matet duke përdorur flukset e parave të vlerësuara për të shlyer detyrimin aktual, vlera e tij kontabël është vlera aktuale e atyre flukseve monetare (kur efekti i vlerës kohore të parasë është material).

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer një provizion pritet të rikuperohen nga një palë e tretë, një e arkëtueshme njihet si pasuri, nëse është praktikisht e sigurt që rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet me besueshmëri.

Provizionet në lidhje me pastrimin dhe rikuperimin e tokës

Bilanci i provizionit paraqet vlerësimin më të mirë të kompanisë për kostot që lidhen me pastrimin dhe rikuperimin e tokës, heqjen e deponive të hirit dhe dekomisionimin nga puna të fabrikës së gazifikimit nga vendet e gjenerimit të energjisë. Këto kosto bazohen në vlerësimet e brendshme të menaxhmentit, ku menaxhmenti beson se afatet e fluksit të parave në këtë drejtim do të jenë 3-10 vite. Ndërsa bëhen vlerësime të provizionit, Kompania shfrytëzoi të gjithë faktorët e lidhur, përfshirë ofertat e mundshme për projekte të tilla, kohën e parashikuar të fluksit të parave dhe informacione të tjera të lidhura me tregun.

Provizionet në lidhje me paaftësinë e personelit

Provizionet njihen në pasqyrat financiare të Kompanisë për pagesa që lidhen me pensionet shtesë dhe qiratë që paguhet bazuar në vendimet gjyqësore për punonjësit e dëmtuar në vendin e punës dhe kanë humbur aftësinë e tyre për të punuar dhe anëtarëve të familjes së tyre në rast se punonjësi ka vdekur në vendin e punës. Menaxhmenti bën vlerësime vjetore në lidhje me bilancin që duhet të llogariten në lidhje me detyrimin e Kompanisë për pagimin e pensioneve shtesë dhe qirave.

2.29 Palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura janë ato kur njëra nga palët kontrollohet nga tjetra ose ka ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare ose të biznesit të palës tjetër.

2.30 Zotimet dhe Kontigjentet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përveç nëse një rrjedhje e mundshme e burimeve që materializojnë përfitimet ekonomike është e largët. Pasuritë kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur një rrjedhje e beneficioneve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, detyrimin e pësuar në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

2.31 Ngjarjet pas datës raportuese

Ngjarjet mëpasshme që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Kompanisë, në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) reflektohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas periudhës raportuese që nuk janë ngjarje rregulluese shpalosen në shënime nëse janë materiale.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

2.32 Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara

Nga njoftimet kontabël të shpallura, për standardet që hyjnë në fuqi nga 1 janari 2024, nuk ka pasur ndryshime që të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike. Standarde dhe ndryshime të tjera që janë efektive për herë të parë në 2024 dhe mund të zbatohen për njësinë ekonomike janë:

- SNK 1 - Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtra ose Afatgjata
- SNK 1 - Detyrimet Afatgjata me Kufizime Kontraktuale
- SNRF 16 - Detyrimi i Qirasë në një marrëveshje shitjeje dhe kthimi me qira
- SNK 7 dhe SNRF 7 - Marrëveshjet e Financimit me Furnitorët

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto pasqyra financiare dhe për këtë arsye nuk janë paraqitur.

Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por që ende nuk janë adoptuar

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka publikuar një sërë standardesh dhe interpretimesh që janë efektive në periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur të mos i zbatojë paraprakisht. Kompania planifikon të zbatojë këto standarde dhe interpretime kur ato të hyjnë në fuqi. Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme janë lëshuar, por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të përfunduar më 31 dhjetor 2025:

- SNK 21 - Mungesa e Shkëmbyeshmërisë *(e zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2025 ose më vonë)*.
- SNRF 9 dhe SNRF 7 - Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare *(e zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2026 ose më vonë)*.
- SNRF 19 - Filialet pa Përgjegjësi Publike: Paraqitja *(e zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2027 ose më vonë)*.
- SNRF 18 - Prezantimi dhe Paraqitja në Pasqyrat Financiare *(e zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2027 ose më vonë)*.

2.33 Riklasifikimi dhe paraqitja krahasuese e zërave në pasqyrat financiare

Gjatë vitit 2025, kompania ka ndryshuar paraqitjen e dy zërave në pasqyrën e pozicionit financiar, duke riklasifikuar një pjesë nga "Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera,neto" në zërin "Asete të tjera afatgjata" dhe një pjesë nga "Të pagueshmet tregtare dhe të tjera" në zërin "Detyrimet e tjera afatshkurtëra" për shkak të ndryshimit në natyrën dhe afatin e realizimit të këtyre mjeteve. Për qëllime krahasueshmërie, shifrat krahasuese për vitin 2024 janë riformatuar në përputhje me këtë paraqitje të re. Ky riklasifikim është kryer në përputhje me kërkesat e SNK1 – Paraqitja e Pasqyrave Financiare, i cili kërkon riklasifikimin e shifrave krahasuese kur ndryshon paraqitja e zërave në pasqyrat financiare dhe ky riklasifikim nuk ka ndikuar në totalin e vlerës të aseteve, detyrimeve apo në rezultatin financiar të kompanisë.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

Pasqyra e pozicionit financiar	2024	2025	Vlera e riklasifikuar
	(EUR' 000)	(EUR' 000)	(EUR' 000)
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera,neto	82,187	81,587	600
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	14,959	12,837	2,122

3. Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të kompanisë

Nuk ka gjykime kritike, përveç atyre që përfshijnë vlerësime (shiko 3.1 më poshtë), që menaxhmenti ka bërë në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Kompanisë dhe që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në këto pasqyra financiare.

3.1 Burimet kryesore për vlerësimin e pasigurisë

Në vijim janë supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në fund të periudhës raportuese, që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të mbajtjes së pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Zhvierësimi dhe jetëgjatësia funksionale e pronës, impianteve dhe pajisjeve

Pasuritë e kompanisë përbëhen nga instalime të mëdha dhe komplekse. Ato janë të shtrenjta për t'u ndërtuar, prirjen të jenë të ekspozuar ndaj kushteve të vështira operative dhe kërkojnë zëvendësim ose riparim periodik. Pasuritë gjeneruese përbëhen nga një numër i konsiderueshëm i komponentëve, shumë prej të cilëve do të kenë jetëgjatësi të ndryshme. Siç përshkruhet në shënimin 2.6 më lart, Kompania rishikon jetëgjatësinë e dobishme të vlerësuar të pasurisë, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave ose faktor tjetër mund të ndikojë në jetëgjatësinë e dobishme të pasurive dhe, në përputhje me rrethanat, mund të ndryshojë ndjeshëm vlerën kontabël të atyre pasurive.

Lejimet nga humbjet e pritshme kreditore

Lejimet për vlerësimin e humbjeve të pritshme kreditore kërkon një shkallë vlerësimi dhe gjykimi. Bazohet në humbjen e pritshme të jetëgjatësisë, e grupuar në bazë të arkëtimit të prapambetura dhe jo të detyrueshme dhe bën supozime për të ndarë një normë të përgjithshme të pritshme të humbjes kreditore për secilin grup. Këto supozime përfshijnë përvojën e shitjeve të fundit dhe nivelet e mbledhjes historike.

Provizionimi për dëmtimin e inventarit

Vlerësimi për provizionim për dëmet e inventarit kërkon një shkallë vlerësimi dhe gjykimi. Menaxhmenti bën vlerësimin e dëmit të inventarit bazuar në lëvizjen e inventarit gjatë vitit. Bilanci i dëmtimeve llogaritet çdo fundvit dhe sigurohet inventari që nuk ka lëvizur për 365 ditë provizionohet.

3. Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të kompanisë (vazhdim)

Provizionet në lidhje me përfitimet e stafit

Provizionet njihen në pasqyrat financiare të kompanisë për pagesa në lidhje me pensionet plotësuese dhe qiratë paguhen bazuar në vendimet gjyqësore, për personat e dëmtuar në vendin e punës që kanë humbur aftësinë për të punuar dhe për anëtarët e familjes së tyre në rast se personi ka vdekur në vendin e punës. Menaxhmenti bën vlerësime vjetore në lidhje me bilancin që duhet të llogariten në lidhje me detyrimin e kompanisë për pagimin e pensioneve shtesë dhe qirave.

Vlerësimi i çështjeve gjyqësore

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësimin për shumat e shlyerjes së çështjeve gjyqësore të udhëhequra nga këshilltari juridik i Kompanisë. Mbi bazën e këtij vlerësimi, Kompania në përputhje me rrethanat regjistron provizionet, nëse ka, ose shpalos përgjegjësinë e mundshme. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

Vlerësimi për çështje mjedisore, dekomisionim dhe çështje të tjera të lidhura

Aktualisht nuk ka kërkesë ligjore detyruese për dispozitat mjedisore, dekomisionimin dhe dispozitat e tjera të lidhura me të në Kosovë. Kompania rregullisht kryen vlerësimet e saj të brendshme për provizione të tilla dhe i njuh ato në varësi të natyrës dhe rrethanave përreth këtyre dispozitave. Në varësi të natyrës dhe madhësisë së operacioneve të Kompanisë në të ardhmen dhe më tej nga çdo ndryshim i mundshëm në kornizën ligjore në Kosovë, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet e Kompanisë.

Tatimet dhe provizionet e tatimeve

Detyrimi tatimor i Kompanisë për aktivitetet operative është shuma e gjithsej detyrimeve tatimore aktuale dhe nje përlllogaritje e provizioneve të detyrimeve të mundshme tatimore e cila është 10% e shpenzimit të përlllogaritur për vitin dhe që mbyllet pas kontrollit final nga autoritetet tatimore. Llogaritja e gjithsej tatimit të Kompanisë përfshin domosdoshmërisht një shkallë vlerësimi dhe gjykimi në lidhje me zëra të caktuar, trajtimi tatimor i të cilave nuk mund të përcaktohet përfundimisht derisa të arrihet një zgjidhje me autoritetin përkatës tatimor ose, sipas rastit të jetë, përmes një procesi zyrtar juridik. Zgjidhja përfundimtare e disa prej këtyre zërave mund të ketë një ndikim material në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe / ose variancave në rrjedhën e parave.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

4. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Toka dhe pyjet (në EUR '000)	Toka në miniera (në EUR '000)	Ndërtesat (në EUR '000)	Pajisjet (në EUR '000)	Ndërtimet në zhvillim e sipër (në EUR '000)	Gjithsej (në EUR '000)
Kosto/Kostot e konsideruara:						
Më 1 Janar 2024	65,004	85,599	46,991	734,700	5,760	938,054
Shtesat	-	30,275	374	10,552	787	41,988
Kthimi i dëmtimit	-	-	-	-	-	-
Rivleresimi i tokave	-	-	-	-	-	-
Shyerjet	-	-	-	(482)	-	(482)
Transferet e brendshme	-	-	-	3,345	(3,345)	-
Transferet në Inventar	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	65,004	115,874	47,365	748,115	3,202	979,560
Më 1 Janar 2025	65,004	115,874	47,365	748,115	3,202	979,560
Shtesat	-	547	1,120	12,367	37,197	51,134
Kthimi i dëmtimit	-	-	-	125	-	125
Rivleresimi i tokave	-	-	-	-	-	-
Shyerjet	-	-	-	(8,827)	-	(8,827)
Transferet e brendshme	-	-	234	35,207	(35,441)	-
Transferet në Inventar	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2025	65,004	116,421	48,719	786,987	4,958	1,022,089

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

4. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET (VAZHDIM)

	Toka dhe pyjet (në EUR '000)	Toka në miniera (në EUR '000)	Ndërtesat (në EUR '000)	Pajisjet (në EUR 000)	Ndërtimet në zhvillim e sipër (në EUR '000)	Gjithsej (në EUR '000)
Zhvlërësimi i akumuluar:						
Më 1 Janar 2024	-	68,163	29,384	566,774	-	664,321
Shtimet për vitin	-	7,602	1,708	38,865	-	48,175
Hegja e pasurive të shlyera	-	-	-	(460)	-	(460)
Më 31 Dhjetor 2024	-	75,765	31,092	605,179	-	712,036
Më 1 Janar 2025	-	75,765	31,092	605,179	-	712,036
Shtimet për vitin	-	5,756	1,515	30,340	-	37,611
Hegja e pasurive të shlyera	-	-	-	(8,702)	-	(8,702)
Më 31 Dhjetor 2025	-	81,521	32,607	626,817	-	740,945
Vlera neto në libra:						
Më 31 Dhjetor 2024	65,004	40,109	16,273	142,936	3,202	267,524
Më 31 Dhjetor 2025	65,004	34,900	16,112	160,170	4,958	281,144

Të përfshira në Pronë, Impiante dhe Pajisjet, nën kategorinë Ndërtimet në Vijim, janë investimet në burime minerale për minierën e re në vlerë prej 2,599 mijë euro më 31 dhjetor 2025 (31 dhjetor 2024; 2,599 mijë euro).

Më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, pajisjet dhe pasuritë minerare të Kompanisë janë kolateralizuar kundër huazimeve nga huatë nga Ministria e Financave (shiko Shënimin 14). Të përfshira në "pronat" dhe "ndërtesat" janë disa prona, të cilat janë nën kontrollin e Kompanisë, por për të cilat Kompania nuk posedon dokumentacionin e duhur të pronësisë. Kompania është në proces të zgjidhjes së çështjes dhe të kompletimit të dokumentacionin me ndihmën e Qeverisë së Kosovës.

KEK ka të evidentuar në regjistrin e aseteve tokë ndërtimore në Prishtinë në sipërfaqe 15.9 ari nga 1.72 ha sa janë në certifikatën e pronësisë, ndërsa për pjesën tjetër (që nuk është në regjistrin e aseteve) të kësaj sipërfaqe është kërkuar historiyati në Komunën e Prishtinës dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës, pasi që KEK nuk e ka në zotërim. Po ashtu, gjatë vitit 2025 kemi pranuar historikun nga AKK dhe Ndërmarrja Publike Banesore (NPB), ku dëshmohet se prona në fjalë i takon KEK.sh.a., e fituar përmes procedurave të shpronësimit kohë më parë. Lidhur me këtë, KEK ka ushtruar padi civile me masë sigurie pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës kundër dy palëve tjera.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

4. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET (VAZHDIM)

Lokali afarist 140 m² - pas pranimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Komerciale-shkalla e dytë ndaj palës së paditur, KEK ka iniciuar kërkesën për ekzekutimin e atij vendimi duke kërkuar lirimin e zyrave, subjekt i këtij kontesti. Megjithatë, e njëjta palë ka zënë pjesën tjetër të objektit, për çka kemi ndërmarrë masa të reja ligjore. Deri në një epilog përfundimtar, KEK do ta shpalojë këtë aset, pasi nuk ka kontrollin mbi të dhe mundësinë e përfitimve ekonomike prej tij.

Lidhur me tokën në Vasilevë (55.7ha) Komuna e Glogocit, KEK është në proces gjyqësor me palën e cila është pronare e kësaj sipërfaqe sipas çertifikatës së pronësisë të vitit 2022. Kompania nuk i ka në regjistrat kontabël këto parcela dhe deri në një vendim përfundimtar nga gjykata, vetëm do ta shpalojë atë në shënime për pasurinë. Ndersa, KEK ka të përfshirë në regjistrin e pasurisë pronat në këtë zonë kadastrale në sipërfaqe prej 61.1 ha, për të cilat posedon edhe certifikatën e pronësisë.

Pesë parcela në Komunën e Podujevës - Keto parcela janë të evidentuara në regjistrin e aseteve të kompanisë (sipas fletës poseduese të vitit 2007, të cilën KEK e ka në posedim), të cilat janë rivlerësuar gjatë vitit 2023, në vlerë 7.867.541€.

Megjithatë, gjatë përditësimit të dokumentacionit ligjor për pronat e kompanisë, është evidentuar që këto parcela, tani janë në pronësi të një pale tjetër. Gjatë vitit të kaluar, kompania ka ushtruar padi ndaj dy palëve të tjera dhe jemi në pritje të vendimit të gjykatës. Menaxhmenti dhe Bordi Drejtorëve kanë vlerësuar që këto pronat të jenë pjesë e regjistrit të aseteve, deri në një vendim përfundimtar gjyqësor.

Gjatë vitit 2025, KEK ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Gjatë këtij viti, KEK ka bërë unifikimin e emrit të korporatës KEK SH.A. të të gjithë dokumentacionin pronësor, duke përfshirë edhe unifikimin e emrit në kuadër të parcelave të KEK.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi KEK ka bërë hartëzimin e të gjitha pronave të cilat i ka në posedim në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, në bashkëpunim me AKK është bërë nxjerrja e Ortofotove të të gjitha parcelave të KEK.

Banesat janë të regjistruara në kontabilitet, të cilat janë ndarë nga investitori KEK (nga ish-subjektet e energjisë që kanë vepruar në Kosovë deri në vitin 1999) për punëmarrësit, si dhe për punëmarrësit të tjerë të sektorit shtetëror, që nga viti 1970 e tutje. Këto banesa janë pjesë e regjistrave kontabël për shkak se nuk janë legalizuar, si dhe nuk kanë qenë subjekt i ndonjë procesi përfundimtar gjyqësor që do të mundësonte bartjen e pronësisë. KEK ka formuar Komisionin për vlerësimin e kriterëve për shitjen e banesave sipas Ligjit Nr. 04/L-061, për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, datë 24 shkurt 2022, si dhe në bazë të Vendimit të MMPHI Nr. 5975/23, datë 13.10.2023, ka shqyrtuar gjithsej 56 kërkesa të aplikantëve për legalizimin e banesave, të cilët kanë aplikuar gjatë vitit 2022-2024. Gjatë vitit 2026, KEK sh.a. do të procedojë më tej me nënshkrimin e kontratave noteriale për kërkesat e aprovuara.

4. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET (VAZHDIM)

Parcelat ne Komunën e Obiliqit – KEK ka 11 parcela të cilat janë të evidentuara në regjistrin e aseteve të kompanisë (sipas fletës poseduese të vitit 2007, të cilën KEK e ka në posedim), të cilat janë rivlerësuar gjatë vitit 2023, në vlerë 866,223€. Megjithatë, gjatë përditësimit të dokumentacionit ligjor për pronat e kompanisë, eshte evidentuar që këto parcela, tani janë në pronësi të disa paleve tjera. Gjatë këtij viti, KEK ka kërkuar historiatin e këtyre pronave ne komunën përkatëse. Bordi Drejtorëve ka vlerësuar që këto prona të jenë pjesë e regjistrit të aseteve deri ne sigurimin e historiatit ku dëshmohet bartja e pronësisë tek nje palë tjetër.

Tokë 1,250 ha, ZK Batllavë në Komunën e Podujevës - KEK ka të evidentuar në regjistrin e aseteve të kompanisë (sipas raportit te korporatizimit të ndermarrjes të vitit 2004), të cilat janë rivlerësuar gjatë vitit 2023, në vlerë 5,000,000€. Megjithatë, gjatë përditësimit të dokumentacionit ligjor për pronat e kompanisë, eshte evidentuar që kjo parcelë, tani është në pronësi të një pale tjetër (ndërmarrje shoqërore). Kompania ka kërkuar historiatin në Agjencë Kosovare të Privatizimit dhe komunën përkatëse. Menaxhmenti dhe Bordi Drejtorëve kanë vlerësuar që kjo pronë të jetë pjesë e regjistrit të aseteve, deri në sigurimin e historiatit ku dëshmohet bartja e pronësisë tek nje palë tjetër.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

5. PASURITË E PAPERKSHME

Pasuritë e paprekshme në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	Softueri (në EUR '000)	Gjithsej (në EUR '000)
Kosto/Kostot e konsideruara:		
Gjendja më 1 Janar 2024	1,218	1,218
Shtesa gjatë vitit	-	-
Transferet	-	-
Shlyerjet	(32)	(32)
Gjendja 31 Dhjetor 2024	1,186	1,186
Shtesa gjatë vitit	-	-
Transferet	-	-
Shlyerjet	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2025	1,186	1,186
Amortizimi i akumuluar:		
Gjendja më 1 Janar 2024	832	832
Amortizimi për vitin	166	166
Shlyerjet	(32)	(32)
Gjendja 31 Dhjetor 2024	966	966
Amortizimi për vitin	128	128
Shlyerjet	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2025	1,094	1,094
Vlera neto në libra më 31 Dhjetor 2024	220	220
Vlera neto në libra më 31 Dhjetor 2025	92	92

6. ASETË TË TJERA AFATGJATA

	31.12.2025 (në EUR '000)	31.12.2024 (në EUR '000)
Garancioni bankar	5,200	-
Kolateral në para	1,200	600
Gjithsej	6,400	600

Garancioni bankar në vlerë 5,210 mijë euro paraqet vlerën e mjeteve të mbajtura nga banka për KOSTT, të cilat janë mjete të kufizuara dhe jo në dispozicion në llogarinë bankare të KEK sipas afatit të marrëveshjes. Kolateral në para në vlerë 1,200 mijë euro paraqet vlerën e mjeteve të mbajtura në bankë për qëllime të tregtimit në bursën shqiptare ALPEX. për qëllime të tregtimit në bursën shqiptare ALPEX.

Garancioni bankar dhe Kolateral në para janë paraqitur si asetë tjera afatgjatë për arsye se afati i maturimit të këtyre marrëveshjeve është përtej periudhës 12 mujore.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

7. STOQET

Stoqet në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	31.12.2025 (në EUR '000)	31.12.2024 (në EUR '000)
Materialet dhe materialet harxhuese	23,773	24,606
Linjit	4,362	4,338
Karburant	1,693	2,092
Pjesë ndërrimi	14,320	13,205
Të tjera	10,550	11,949
	54,698	56,190
Provizionimi për stoqet e vjetërsuara	(36,401)	(36,583)
	18,297	19,607

Lëvizjet në llogarinë e provizionimit të stoqeve paraqiten si më poshtë:

	31.12.2025 (në EUR '000)	31.12.2024 (në EUR '000)
Gjendja më 1 Janar	(36,583)	(37,518)
Ngarkesa për periudhën		-
Lirimi i provizionit	182	935
Gjendja më 31 Dhjetor	(36,401)	(36,583)

8. TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Të arkëtueshmet tregtare në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	31.12.2025 (në EUR '000)	31.12.2024 (në EUR '000)
Të arkëtueshme tregtare:		
Të arkëtueshme nga shitja e energjisë	95,971	49,154
Të arkëtueshme nga shitja e energjisë FEE	16,240	
Të arkëtueshme nga shitja e qymyrit	498	498
Të arkëtueshme nga shërbimet	3,613	3,537
Interesi aktual nga të arkëtueshmet	15,840	9,996
	132,162	63,185
Minus Lejimet	(14,019)	(21,262)
	118,143	41,923
Të arkëtueshmet tjera dhe avanset:		
Avanset ndaj furnitorëve	19,863	39,515
TVSH e arkëtueshme	1,262	-
Të arkëtueshmet tjera	1,086	149
	22,211	39,664
Gjithsej të arkëtueshmet tjera	22,211	39,664
Gjithsej	140,354	81,587

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

8. TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA (VAZHDIM)

Të arkëtueshme tregtare janë shuma për tu paguar nga klientët për shitje të energjisë elektrike, avullit të kogjenerimit, qymyrit, etj në rrjedhën e zakonshme të biznesit. Të arkëtueshme tregtare zakonisht pranohen brenda 30 ditësh dhe për këtë arsye klasifikohen të gjitha si afatshkurtra. Llogaritë e arkëtueshme dhe paradhëniet e tjera janë të përbëra nga paradhëniet që u janë dhënë furnitorëve për punë dhe shërbime që duhen kryer, ndërsa arkëtimet e tjera janë shuma për shkak të klientëve për shërbimet e kryera. Për analiza të mëtejshme mbi lejimin e zhvlerësimit dhe rrezikun e kredisë, ju lutemi referojuni Shënimit 33.B.

Interesi aktual nga te arketueshmet përfaqëson të arkëtueshmen në lidhje me pagesat e vonuara të faturave të energjisë elektrike nga KEDS / KESCO, KOSTT dhe Trepça.

Avanset ndaj furnitorëve në vlerë 19,863 mijë me 31 Dhjetor 2025 (39,515 mijë me 31 Dhjetor 2024) paraqesin vlerën për avanset e furnitorëve për modernizimin e turbinave.

9. PARAJA NË DORË DHE NË BANKË

Paraja në dorë dhe në bankë në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	31.12.2025 (në EUR '000)	31.12.2024 (në EUR '000)
Llogaritë rrjedhëse në banka	43,959	2,632
Paraja në dorë	6	7
	43,965	2,639

10. DEPOZITAT ME AFAT

Depozitat me afat në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	31.12.2025 (në EUR '000)	31.12.2024 (në EUR '000)
<u>Afatshkurtër</u>		
Depozitat në bankat komerciale lokale- afatshkurtër	130,000	165,900
Interesi aktual nga depozitat	2,689	3,466
Provizonet për humbjet e pritura kreditore	(89)	(361)
	132,600	169,005
<u>Afatgjatë</u>		
Depozitat në bankat komerciale lokale- afatgjatë	-	48,000
Provizonet për humbjet e pritura kreditore	-	-
	-	48,000
Gjithsej depozitat me afat	132,600	217,005

Normat e interesit për depozitat me afat të shkurtër për vitin fiskal 2025 3.20% deri në 4.5% në vit. Tatimi në burim prej 10% zbatohet në të ardhurat nga interesi në depozita me afat dhe mbahet nga bankat me pagesën e interesit për kompaninë.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

11. INVESTIMET NË LETRA ME VLERË

Investimet në letra me vlerë në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2025 (në EUR' 000)	31 Dhjetor 2024 (në EUR' 000)
<u>Afatshkurtër</u>		
Investimet në letra me vlerë- afatshkurtër	-	25,885
Interesi akrual nga bondet	-	192
Provizonet për humbjet e pritura kreditore	-	(14)
	-	26,063
<u>Afatgjatë</u>		
Investimet në letra me vlerë- afatgjatë	-	-
Provizonet për humbjet e pritura kreditore	-	-
	-	-
Gjithsej investimet në letra me vlerë	-	26,063

12. KAPITALI AKSIONAR

Më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 dhe sipas Regjistrimit të Biznesit të lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë nën Reg. Nr. 70325399, kapitali i përgjithshëm i pajtuar arrin në 25 mijë euro. Përmban 25,000 aksione të zakonshme me 1 (një) euro për aksion. Aksionari i vetëm i Kompanisë është Qeveria e Kosovës.

13. REZERVAT

Rezervat, të cilat më 31 dhjetor 2025 kapin shumën 253,182 mijë euro (2024: 253,066 mijë euro) fillimisht janë llogaritur në librat e Kompanisë, si diferencë midis kapitalit të regjistruar të aksioneve dhe vlerës së pasurive neto të Kompanisë, siç përcaktohet nga vlerësimi i pavarur në data e përfshirjes së saj si SHA (1 janar 2005). Këto rezerva hiqen nga shitja e pasurive të lidhura. Më tej, këto rezerva nuk janë të disponueshme për shpërndarje tek aksionari.

Rezervat përfshijnë gjithashtu efektin e tatimit të shtyrë (lëshimin e detyrimit tatimor të shtyrë) të krijuar fillimisht në bazë të rivlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve pas kalimit në SNRF.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

14. HUAMARRJET

Kompania ka marrë hua afatgjata dhe afatshkurtra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si më poshtë:

	31.12.2025 (në EUR '000)	31.12.2024 (në EUR '000)
Pjesa afatgjatë		
Kredi me interes nga Ministria e Financave	84,858	94,841
	84,858	94,841
Pjesa afatshkurtër		
Kredi me interes nga MF - Pjesa afatshkurtër	9,983	9,151
Interesi i akrual (jo i vonuar)	500	548
	10,483	9,699
Gjithsej huazimet	95,341	104,540

Kreditë e qeverisë:

Kredia e parë në vlerë prej 166,367 mijë euro është për Miniera dhe shuma kryesore dhe interesi paguhet në 18 vjet në 36 këste të barabarta, përveç pagesës së interesit të parë prej 1,500 mijë euro, e cila është paguar më 15 tetor 2015. Kryegjëja dhe interesi paguhet duke filluar nga 15 tetori 2018 dhe bart interes në normën maksimale 2.5% p.an. Kredia sigurohet ndaj pengut të impianteve dhe pajisjeve të kompanisë (shiko Shënimin 4). Kredia e dytë në vlerë prej 25,565 mijë euro është për gjenerim dhe shuma kryesore dhe interesi janë të ripagueshme në 9 vite në 18 këste të barabarta duke filluar nga 15 prill 2016 dhe bart interes në normën 2.5% p.a në maksimum, e cila është paguar tashmë, me këstin e fundit të paguar në Tetor 2025. Kredia sigurohet ndaj pengut të pronës, impianteve dhe pajisjeve të kompanisë (shiko Shënimin 4).

Plani i ripagimit të kredive është si më poshtë:

	Gjithsej në EUR'000
Brenda 12 muajve	9,983
2026	9,983
2027	9,983
2028	9,983
2029	9,983
Pas vitit 2029	44,926
	94,841

14.1 Rakordimi i borxhit neto

	31.12.2025 (në EUR '000)	31.12.2024 (në EUR '000)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	43,965	2,639
Depozitat afatshkurtra	132,600	169,005
Investimet në letra me vlerë- afatshkurter	-	26,063
Huamarrjet – të pagueshme brenda një viti	(10,483)	(9,699)
Huamarrjet – të pagueshme pas një viti	(84,858)	(94,841)
Borxhi neto	81,224	93,167
Paraja dhe investimet likuide	176,565	197,707
Borxhi bruto - normat e interesit të ndryshueshme	(95,341)	(104,540)
Borxhi neto	81,224	93,167

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

14 HUAZIMET (vazhdim)

14.2 Ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit

	1 Janar 2025	Rrjedhjet e parasë	Ndryshimet jo monetare	31 Dhjetor 2025
	EUR '000	EUR '000	EUR '000	EUR '000
Huazimet afatshkurtra me interes	9,151	832	-	9,983
Huazimet afatgjata me interes	94,841	(9,983)	-	84,858
	103,992	(9,151)	-	94,841

	1 Janar 2024	Rrjedhjet e parasë	Ndryshimet jo monetare	31 Dhjetor 2024
	EUR '000	EUR '000	EUR '000	EUR '000
Huazimet afatshkurtra me interes	11,387	(2,236)	-	9,151
Huazimet afatgjata me interes	103,992	(9,151)	-	94,841
	115,379	(11,387)	-	103,992

15. GRANTET E SHTYERA

Kompania ka grante të shtyera të pranuar para vitit 2010 nga Qeveria e Republikës së Kosovës për financimin e pasurive afatgjata. Në vitin 2025 kompania ka grante të shtyera të pranuar nga KfW banka zhvillimore e pronësisë shtetërore gjerman për financim të projektit Solar4Kosovo. Bilanci i mbetur në 31 dhjetor 2025 dhe 2024 është si më poshtë:

	31.12.2025	31.12.2024
	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Më 1 Janar	4,332	6,049
Grantet e pranuar gjatë vitit	124	
Të amortizuar gjatë vitit (Shënimi 22)	(1,362)	(1,717)
Gjendja më 31 Dhjetor	3,094	4,332

15.1 GRANTET E SHTYERA - IMPORTI I ENERGJISË

Kompania ka marrë grante nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar koston e energjisë elektrike të importuar në mënyrë që të plotësojë nevojat e përdoruesve të fundit të energjisë elektrike. Subvencioni i marrë dhe kostot që lidhen me importin e energjisë elektrike janë si më poshtë:

	31.12.2025	31.12.2024
	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Më 1 Janar,		
Grantet e pranuar gjatë vitit	-	16,199
Pagesat per TVSH	-	-
Të liruara / (kthyer) gjatë vitit	-	(16,199)
Gjendja më 31 Dhjetor,	-	-

Me datë 11 Prill 2024 Kompania ka kthyer pjesën e grantit të pa shpenzuar ne vlere 16,199 mije EURO dhe interesin e fituar ne vlere 54 mije Euro.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

16. PROVISIONET

Provizionet e Kompanisë siç tregohet në pasqyrën e pozicionit financiar janë analizuar më tej si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2025 (në EUR '000)					Më 31 Dhjetor 2024 (në EUR '000)					
	Pastrimi dhe rikuperimi i tokës	Çështjet gjyqësore	Pensioni i stafit	Konteste	Provizio net tatimore	Pastrimi dhe rikuperimi i tokës	Çështjet gjyqësore	Pensio ni stafit	Konteste	Provizio net tatimore	Gjithsej
Gjendja më 1 Janar,	41,435	14,119	563	1,957	590	40,591	12,332	582	1,957	2,483	57,945
Shtesa gjatë vitit	-	4,798	191	-	186	-	3,093	39	-	590	3,722
Ndryshimi / lirimet gjatë vitit	-	(490)	-	-	-	(109)	(1,306)	(70)	-	(2,483)	(3,968)
Pagesa gjatë vitit	-	(1,721)	(69)	-	-	-	-	-	-	-	-
Interesi ngarkuar	950	-	12	-	-	953	-	12	-	-	965
Më 31 Dhjetor,	42,385	16,706	697	1,957	775	41,435	14,119	563	1,957	590	58,665

Provizionet për pastrimin dhe rikuperimin e tokës:

Bilanci i provizionit më 31 dhjetor 2025 paraqet vlerësimin më të mirë të kompanisë për kostot që lidhen me pastrimin dhe rikuperimin e tokës, heqjen e deponive të hirit dhe dekomisionimin e bimëve të gazifikimit nga vendet e gjenerimit të energjisë. Këto kosto bazohen në vlerësimet e brendshme të menaxhmentit, ku menaxhmenti beson se afatet e rrjedhjes së parasë në këtë drejtim do të jenë 3-10 vjet. Ndërsa bënte vlerësimet të provizionit, Kompania shfrytëzoi të gjithë faktorët e lidhur, përfshirë ofertat e mundshme për projekte të tilla, kohën e parashikuar të fluksit të parave dhe informacione të tjera të lidhura me tregun.

Më poshtë jepet ndarja e provizioneve të pastrimit dhe rikualifikimit të tokës:

	31.12.2025 (në EUR '000)	31.12.2024 (në EUR '000)
Hegja e gropës së hirit	5,837	5,837
Hale mbingarkese	16,048	16,048
Trajtimi i kemikaleve të rrezikshme	12,516	12,516
Trajtimi i derdhjeve të ujit	3,606	3,606
Interesi ngarkuar (akumuluar)	4,378	3,428
	42,385	41,435

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
